AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Arteve në "Aktrim dhe Mësuesi"**
**ofruar nga Universiteti i Arteve**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**


**Prof As. Emin EMINI**

**Prof As. Dilina BESHIRI**


**Maj / 2023**

## TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

### Master i Arteve në "Aktrim dhe Mësuesi"

| | | |
|---|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Universiteti i Arteve |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Aktrimit dhe Teori |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Master i Arteve në Aktrim dhe Mësuesi |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: ` | Urdhër Nr. 821, datë 26.12.2018 |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | - |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | UMASR Nr 146, datë 19.09.2018 |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | - |
| 8 | Cikli i studimit: | Cikli i dytë |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 2 (Dy) vite akademike |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 120 ECTS |
| 11 | Forma e studimit: | Me kohë të plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Gjuha Shqipe |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | Programi ofrohet vetëm nga UART |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | Niveli 7 (shtatë) |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | 13 PAE / 5 PAK |
| 18 | Numri i studentëve: | 2020-2021; 7 studentë;<br>2021-2022; 6 studentë; |

**TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i studimit Master i Arteve në "Aktrim dhe Mësuesi" për herë të parë është objekt i vlerësimit në kuadër të akreditimit të tij.

Programi i studimit është licensuar me Urdhërin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Nr. 397, datë 10.08.2011 "Për hapjen e programeve të ciklit të dytë Mastër Profesional; Master i Shkencave dhe Master i Arteve të Bukura në Fakultetin e Muzikës, Fakultetin e Artit Skenik dhe Fakultetin e Arteve të Bukura të Universitetit të Arteve të Tiranës", me emërtimin Master i Arteve të Bukura në "Aktrim".

Për të qënë sa më afër kërkesave të kohës dhe në përputhje me tregun e punës, Departamenti i Aktrim dhe Teorisë toku edhe me gjitha programet e tjera që ofrohen në gjithë Fakultetin e Artit Skenik, i propozoi Ministrisë së Arsimit riorganizimin e programeve të ciklit të dytë të studimit duke mundësuar ofrimin e tyre edhe në fushën e Mësuesisë. Me këtë qëllim, programet e studimit të ciklit të dytë të ofruara në UART, u riorganizuan me UMASR Nr. 821, datë 26.12.2018 "Për riorganizimin e programeve të studimit të Ciklit të Dytë në Universitetin e Arteve" dhe programi në fjalë, objekt vlerësimi i GVJ riorganizohet me emërtimin Master i Arteve në "Aktrim dhe Mësuesi".

**PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;**

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) pas dakordësimit me Ekspertët e jashtëm për të qenë pjesë e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), realizoi trajnimin e tyre me Specialisten e ASCAL, Znj Majlinda Demirneli. Menjëherë, pas trajnimit, GVJ – së ju mundësua qasja në sistemin e ASCAL për të mundësuar dhe shqyrtuar dosjen e Vetëvlerësimit, realizuar nga Universiteti i Arteve, Fakulteti i Artit Skenik, Departamenti Aktrim dhe Teori, për programin e studimit -objekt vlerësimi, Master i Arteve në "Aktrim dhe Mësuesi". Dosja e vetëvlerësimit përmban Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, Rregulloren e Programit të Studimit, Syllabuset, Planin Mësimor si dhe gjitha shkresat e evidencat përkatëse të ngarkuara në sistem.

Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Prof. As. Emin Emini dhe Prof.Asoc.Dr. Dilina Beshiri dhe gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, për realizimin e këtij vlerësimi u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkruara nga Ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr.531, datë 11.9.2018 "Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë", VKM Nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë", në VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", në Udhëzimin e MASR Nr. 1, datë 14.1.2020, për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", Udhëzimin e MASR Nr. 22, datë 3.9.2020, "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020", "Për dokumentacionin dhe procedurat per hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë" si dhe gjithë aktet e tjera nënligjore që kanë të bëjnë me organizmin e studimeve në institucionet e arsimit të lartë.

Të gjitha takimet e punës në institucion u zhvilluan sipas agjendës të miratuar nga ne si ekspertë vlerësimi, agjendë të cilën e diskutuam edhe me përfaqësuesen e ASCAL. Takimet në institucion nisën me zhvillimin e diskutimeve me Dekanin e Fakultetit të Artit Skenik, Përgjegjësin e Departamentit të Aktrimit dhe Teorisë, Grupin e Vlerësimit të brendshëm të programit të studimit, Stafin akademik të programit, studentët, Komisionin AD HOC të Sigurimit të Cilësisë në UART; Sektorin Mësimor, të Kurikulës, Këshillimit të Studnetëve dhe ALUMNI, përfaqësues të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, si dhe përfaqësues të sekretarisë mësimore. Gjithashtu u realizua edhe një vizitë e auditorëve, atelieve, sallave, bibliotekës, që mundësojnë veprimtarinë arsimore, hulumtuese, kërkimore-shkencore, krijuese artistike e skenike dhe gjatë gjithë kohës kjo vizitë u shoqërua me diskutime të detajuara për elementë lidhur me këtë infrastrukturë.

Vlerësimi i Programit të studimit u fokusua në disa segmenete, si në: vendosjen e objektivave të të mësuarit në analizën e programit, në shqyrtimin e syllabuseve: specifikën e orëve mësimore të zhvilluara; kompetencat që synohen të fitohen, rrugët nëpërmjet të cilave fitohen (metodat e mësimdhënies), literaturën bazë dhe atë shtesë, mënyrat e vlerësimit të dijeve, përcaktimin e krediteve, kualifikimin e stafit akademik, etj. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e lartpërmendura, në takimet e zhvilluara me aktorët relevantë si dhe në dokumentacionin e materialet që iu vunë në dispozicion GVJ-së, sipas kërkesave të parashtruara.

Universiteti i Arteve është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 14.04.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 52/41 Prot, datë 14.04.2023. Universiteti i Arteve më datë 19.04.2023, njofton me anë të shkresës Nr. 114 Prot, datë 19.04.2023, "Mbi Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit MA në "Aktrim dhe Mësuesi".

*Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:*

1. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin IV.3, kriteri 4:**

**GVJ ndër të tjera komenton**: Rekomandohet shtimi i fondit të teksteve fizike dhe elektronike në fushën e edukimit (literature bazë dhe e këshillueshme) për plotësimin e nevojave të studentëve në realizimin e leksioneve, detyrave dhe projekteve, kurseve me karakter psiko-pedagogjik që ky program studimi ofron për formimin e mësuesve të ardhshem.

**Në lidhje me çfarë është shprehur GVJ, DAT argumenton:** Departamenti i Aktrim dhe Teori e vlerëson gjetjen dhe rekomandimin e lëshuar nga GVJ. Ndërkohe dëshiron të vërë në dukje se pajisja e Bibliotekës së UART me tituj të rinj është një proces i përditshëm, nese mund të shprehemi kështu, i cili nuk mbaron kurrë. Në punën që bën çdo vit Departamenti Aktrim dhe Teori për vetevlerësimin dhe rishikimin e programit të studimit, pas analizave që u bëhen kurrikulave të lëndëve të secilit program studimi ndodh edhe listimi i literatures së rifreskuar për secilën kurrikul. Gjithashtu është detyrim i brendshëm i Departamentit Aktrim dhe Teori të paraqesë në projekt-buxhetin e vitit pasardhë sparashikimin monetar për pajisjen me titujt e rinj të përditësuar. Për çdo program studimi në varësi të këtij departamenti. Sigurisht kësaj rradhe do t'i kushtohet edhe vëmendje e posaçme rekomandimit të lënë nga GVJ. Kjo sigurisht pas konsultimit më nga afër edhe me personelin akademik (kryesisht të tuar) i cili mbulon grupin e lëndëve pedagogjike në UART.

**Përgjigjja GVJ:** GVJ vlerëson përkushtimin e institucionit për të marrë masa në të ardhmen për shtimin e fondit të librave me karakter psiko-pedagogjik dhe ***i qëndron vlerësimit fillestar të standardit: përmbushet kryesisht.***

2. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin V.4, kriteri 5:**

**GVJ ndër të tjera komenton**: Institucioni nuk ka paraqitur një raport analitik periodik mbi cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre.

**Në lidhje me çfarë është shprehur GVJ, DAT argumenton:** Programet e studimit të Departamentit Aktrim dhe Teori, janë programe të cilat varen në cilësinë e punës së tyre nga disa faktorë. Një prej tyre është edhe faktori i përfshirjes apo i studentëve të programit Master i Arteve në Aktrim dhe Mësuesi në cikle të mëparshëm studimi në specialitetin në fjalë. Si parantezë, Programi i kësaj lënde (aktrim) në bachelor, mbështeten tërësisht në prurje të cilat vijnë nga gjimnaze, shkolla profesionale apo edhe artistike, të cilat nuk kanë në kurrikulën e tyre formim aktorial. Kjo, bashkëlidhur me procesin e pranimit të studentëve në FAS vetëm me konkurs për shkak të vlerave të pritshme të paraqitur nga kandidatët, e bën të pamatshme krahasimin e studentëve në hyrje me atë çka ata kanë si bagazh në dalje. Pothuajse e njëjta strukturë aplikohet edhe në programet e Ciklit te Dytë Master i Arteve të cilët kanë studentë që pranohen nga cikli i meparshëm i këtij programi, por për shkak të kuotave të lira, të drejtës së transferimit të studimeve apo të konkurimit nga një specialitet në një tjetër e bën këtë raport analitik vlerësimi të paaplikueshëm. Departamenti i Aktrim dhe Teori, mendon se këtë vlerësim e ka bërë gjatë procesit të vlerësimin me notë të studentit. Ajo çka e shqetëson departamentin Aktrim dhe Teori për shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programeve të tij është aftësia e tregut për të thithur gjithë studentët që dalin nga këto programe. Me krenari vazhdojmë të themi që meritokracia ka mundësuar që studentët tanë më cilësorë të jenë bërthamë e jetës artistike në programet në fjalë dhe në shumë raste edhe vetë drejtuesit e këtyre institucioneve. Aktualisht, Teatri Kombëtar Eksperimental dhe Teatri i Metropolit drejtohen nga alumne të FAS. Po e njëjta situatë verifikohet edhe në një numër të madh televizionesh, jo vetëm në Shqipëri por edhe në rajon.

**Përgjigjja GVJ:** GVJ vlerëson përkushtimin e institucionit dhe angazhimin e tij në përgatitjen e artisteve të rinj dhe kontributin e tyre në jetën artistike shqiptare e më gjerë, por ***i qëndron vlerësimit fillestar të standardit: përmbushet kryesisht.***

3. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin VI.2, kriteri 1:**

**GVJ ndër të tjera komenton**: Rekomandohet ngritja e NJSBC dhe Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Bredshëm të Cilësisë referuar, Nenit 35 të Statutit UART.

**Në lidhje me çfarë është shprehur GVJ, DAT argumenton:** Departamenti i Aktrim dhe Teori e vlerëson gjetjen dhe rekomandimin e lëshuar nga GVJ. Duke kuptuar rëndësinë e rekomandimit të lëshuar nga GVJ, Departamenti Aktrim dhe Teori merr përsipër të përdorë influencën e vet pranë Dekanatit të FAS si dhe të anëtarëve të këtij departamenti të cilët janë përfaqësuesit tanë në Senatin Akademik të UART për të zgjidhur në mënyrë institucionale dhe përfundimtare edhe çështjen e sigurimit të cilësisë nëpërmjet ngritjes, sipas rekomandimit, të Njësisë Permanente Për Sigurimin e Cilësisë në UART.

**<u>Përgjigjia GVJ:</u>** GVJ vlerëson përkushtimin e institucionit dhe departamentit për të influencuar në Senatin Akademik për ngritjen e NJSBC dhe Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, **por *GVJ i qëndron vlerësimit fillestar***

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Arteve në "Aktrim dhe Mësuesi"**

## I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi I.1**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Programi i studimit Master i Arteve në "Aktrim dhe Mësuesi" i ofrur nga Departamenti Aktrim dhe Teori, në Fakultetin e Artit Skenik - Universiteti i Arteve, në radhë të parë u shërben interesave kombëtare duke ofruar mundësi unike edukimi në fushën e aktrimit, gjithnjë duke synuar ruajtjen, kultivimin, konsolidimin, avancimin dhe promovimin e vlerave akademike si dhe kulturore kombëtare.<br><br>Sipas Dekanit të Fakultetit të Arteve Skenike (FAS) dhe Përgjegjësit të Departamentit, gjatë takimit të zhvilluar, programi i studimit në të gjithë veprimtarinë e tij synon në mënyrë të vazhdueshme të arrijë standardet akademike më të larta bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe, po kështu përkrah aspiratat arsimore dhe arritjet e studentëve, duke i nxitur ata të rrisin nivelin e tyre të formimit, të kualifikimit, të kreativitetit dhe të angazhimit duke gërshetuar njohuritë teorike me ato praktike. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | Bazuar në dokumentacionin dhe materialet e vëna në dispozicion nga Institucioni, si dhe duke u mbështetur edhe në takimet me drejtusit e FAS, Programi i studimit është në përputhje me Misionin e Institucionit dhe me fushën e veprimtarisë.<br><br>Sipas Statutit të UART, Neni 4 Misioni i UART është:<br><br>*a) të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, në fushën e artit dhe kulturës si dhe të nxisë e të zhvillojë kërkimin artistik shkencor;*<br><br>*b) të formojë specialistë të lartë të fushave të arteve dhe të përgatisë artistë të rinj, në përputhje me prioritetet e* |

| | |
|---|---|
| | *zhvillimit të vendit;*<br>*c) të ofrojë mundësi të barabarta për të përfituar nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës;*<br>*d) të kontribuojë në zhvillimin artistik, ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal;*<br>*e) të mbështesë prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit;*<br>*f) të integrojë mësimdhënien me kërkimin artistik-shkencor;*<br>*g) të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë dhe më gjerë;etj*<br>Misioni i UART është në përputhje edhe me Misionin dhe Qëllimet e Departamentit të Aktrimit dhe Teori. Sipas nenit 4:<br>*Departamenti Aktrim dhe Teori, ka për qëllim kryesor organizimin e procesit të mësimdhënies, atij artistik-kërkimor-shkencor, zhvillimin dhe përhapjen në nivele më të larta intelektuale të dijes në fushën e Aktrimit dhe Teorisë.*<br>*Departamenti Aktrim dhe Teori promovon zhvillimin e studimit, procesit mësimor artistik dhe të kërkimit shkencor, bashkëpunimin në shkallë të gjerë me institucione të arsimit të lartë dhe të kulturës, kombëtare dhe ndërkombëtare, bashkëpunimin dhe hapjen ndaj komunitetit artistik, shkencor kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe bashkëpunimin me administratën shtetërore dhe lokale.*<br>*Departamenti Aktrim dhe Teori aspiron përmbushjen e misionit të tij arsimor në frymën e lirisë dhe të respektit të dinjitetit human, pluralizmit të ideve, transparencës së procedurave si dhe promovon mendimin e lirë të pedagogëve dhe studentëve.* |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat | Referuar Planit strategjik të UART për vitin 2018-2025, të miratuar me VBA Nr 15/1, datë 24.10.2017, *Vizioni strategjik i Institucionit është integrimi rajonal, evropian dhe global, duke çuar më tej atë traditë që e bën UART një nga IAL-të shqiptare konkurrente me produktin e saj në tregun evropian dhe botëror.* Sipas Dekanit të FAS, UART operon në një treg global, duke konkurruar brenda vetes dhe brenda vendit për t'i shërbyer atyre që duan të shkollohen në Shqipëri. Po kështu, FAS/UART synon |

| | |
|---|---|
| e drejtimet akademike së Institucionit. | për të plotësuar të gjitha nevojat e tregut të shkollimit artistik duke përafruar politikat konkurruese të tregut vendas me atë të huaj. Boshtet kryesore mbi të cilat mbështetet Njësia kryesore e ofrimit të këtij Programi, FAS, janë:<br>- Edukimi;<br>- Krijimtaria artistike dhe Kërkimi Shkencor;<br>- Produksioni artistik dhe menaxhimi i tij; |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar. | Nëpërmjet një kurrikule të ndërtuar me kujdes dhe në përputhje me fushën e studimit të aktrimit, Programi i studimit mbështet dhe aftëson studentët për kryerjen e studimeve artistike-kërkimore-shkencore për të zhvilluar e tejçuar në nivele të larta artin e kulturën; synon formimin e studiuesve të rinj në fushat teorike të vlerësimit të artit e kulturës; thellimin e kualifikimit profesional e artistik dhe shkencor të specialistit të lartë në fushën e artit e kulturës; ofron ndihmesën në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit dhe cilësisë së shoqërisë si dhe përgatitjen e të rinjve për një shoqëri të tillë.<br>Nëpërmjet Programit të studimit, studentët:<br>- aftësohen për të menduar dhe vepruar në të njëjtën kohë<br>- për të gjykuar në situata specifike<br>- edukohen me vlera akademike sipas eksperiencës më të mirë ndërkombëtare. |
| **Konkluzione** | Referuar sa më sipër, Programi ï studimit Master i Arteve në "Aktrim dhe Mësuesi:<br>- *Është në përputhje me Misionin dhe vizionin e UART*<br>- *Nuk bie ndesh me interesat kombëtare, përkundrazi, u shërben interesave kombëtare duke ofruar mundësi unike në fushën e aktrimit*<br>- *Programi ofrohet në përshtatje edhe me planin strategjik të UART* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi I.2** |
|---|

| Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | *Historik i shkurtër:* UART, është themeluar në vitin 1966, në fillimet e tij si Instituti i Lartë i Arteve, dhe më pas duke bashkuar tri institucione artistike: Shkollën e Lartë të Aktorëve "Aleksandër Moisiu", themeluar më 1956 pranë Teatrit Kombëtar, Konservatorin Shtetëror të Tiranës dhe Shkollën e Arteve të Bukura.<br>Fakulteti i Artit Skenik është pasardhës dhe vazhdues i Shkollës së Lartë të Aktorëve "Aleksandër Moisiu", dhe me themelimin e Institutit të Lartë të Arteve u përfshi si Njësi Bazë e Dramës me synim specifik përgatitjen e aktorëve të ardhshëm.<br>Më 1980 hapja e programeve të studimit të aktrimit ishte një kërkesë e kohës për shkak të intensifikimit të jetës teatrore e skenike në Shqipëri.<br>Aktualisht në këtë Fakultet ofrohen 5 programe Bsc, 5 programe Master i Arteve (një prej të cilëve edhe programi ynë objekt vlerësimi) si dhe programi i ciklit të tretë Dr në Ártet Skenike.<br>Gjatë takimit me Dekanatin e FAS, GVJ ju komunikua fakti se UART është institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë me karakter akademik, artistik dhe shkencor me veprimtari në fushën e arteve.<br><br>Referuar *(Tabela Nr. 1 FAS per tre vite akademike 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022),* konstatojmë se Fakulteti i Artit Skenik për vitin akademik 2021-2022 ka gjithsej **72 pedagogë**, nga të cilët **44 janë pedagogë efektiv (PAE)** nga ku: 13 kanë titullin "Profesorë", 15 kanë titullin "Profesor i Asociuar", 8 kanë gradën Dr./PhD, dhe 8 Asistent Lektorë me Msc; dhe **28 pedagogë me kontratë (PAK)** nga ku 2 ka titullin "Profesor", 1 ka titullin "Profesor i Asociuar", 3 kanë gradën Dr./PhD. dhe 22 Asistent Lektorë me Msc.<br><br>Ndërsa Departamenti i Aktrimit dhe Teorisë për vitin akademik 2021-2022 ka gjithsej **23 pedagogë**, nga të cilët **16 janë pedagogë efektiv (PAE)** nga ku: 4 kanë titullin "Profesorë", 3 kanë titullin "Profesor i Asociuar", 6 kanë gradën Dr./PhD, dhe 3 Asistent Lektorë me Msc; dhe 7 **pedagogë me kontratë (PAK)** |

| | |
|---|---|
| | nga ku 1 ka titullin "Profesor", 4 kanë gradën Dr./PhD. dhe 2 Asistent Lektorë me Msc. *(Tabela Nr. 2 Aktrim dhe Teori.pdf)* |
| **Kriteri 2.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | Mbështetur në Rregulloren e Fakultetit të Artit Skenik por edhe në Rregulloren e Departamentit të Aktrimit dhe Teorisë, fusha e programit, Aktrim dhe Mësuesi është në përputhje të plotë me fushën e akademike dhe kërkimore të Njësisë kryesore, FAS. Fakulteti dhe Departamenti kanë bazën e tyre Rregullative të miratuar me Vendim Senati të UART.<br><br>Fakulteti iArtit Skenik kryen veprimtarinë mësimore, artistike – kërkimore - shkencore në fushën e arteve, shkenca humane kodi 02, atë të përgjithshme arte kodi 021 dhe specifike Aktrim kodi 0215. Veprimtaria mësimdhënëse në Fakultetin e Artit Skenik ofrohet edhe në fushën e edukimit 01 dhe atë specifike të formimit të mësuesve 0114. *(Evidenca 2.3); (Evidenca 2.4.1)* |
| **Kriteri 3.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje. | Duke ju referuar strukturës së Fakultetit të Artit Skenik dhe programeve të ofruara të studimeve, si ato të ciklit të parë por edhe programet e ciklit të dytë, GVJ konstaton se ky Fakultet ka në përbërjen e tij 3 njësi bazë (tre departamente) përkatësisht:<br><br>**1.** Departamentin e Rregji, Regji Filmi dhe Televizioni;<br>**2.** Departamentin e Aktrimit dhe Teori;<br>**3.** Departamentin e Skenografi - Koreografi;<br><br>të cilat garantojnë formimin në diploma që lidhen me Aktrimin, Regjinë, Regjinë e Teatrit, Regjinë e Filmit dhe Televizionit, Skenografinë dhe Koreografinë të ndërthurura shumë mirë midis tyre [*Ev. Rregullore e Fakultetit te Artit Skenik*]. Në këtë mënyrë, GVJ konkludon se ka një përputhje ndërmjet fushës së përgjithshme dhe specifike të programit të studimit dhe fushës akademike e kërkimore - artistike shkencore të Fakultetit të Artit Skenik. |
| **Kriteri 4.** Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, | Nuk aplikohet ky kriter për këtë program, pasi është Master i Arteve. |

<table>
<tr><td>cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</td><td colspan="4"></td></tr>
<tr><td>Kriteri 5. Institucioni i arsimi të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</td><td colspan="4">Në FAS aktualisht nuk ofrohen trajnime profesionale të mëtejshme për studentët.</td></tr>
<tr><td>Konkluzione</td><td colspan="4">Programi i studimit në proces vlerësimi është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Artit Skenik si dhe me fushën akademike dhe kërkimore të Departamentit përgjegjës për këtë program studimi.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Shkalla e përmbushjes së standardit</td><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td colspan="2">Standardi I.3<br>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</td></tr>
<tr><td>Kriteret</td><td>Vlerësimi i ekspertëve</td></tr>
<tr><td>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</td><td>Dakanati i FAS, gjatë takimit të përbashkët ju komunikoi GVJ se në fillim të çdo viti akademik, në Dekanat diskutohen prioritetet dhe objektivat, detyrat dhe përgjegjësitë e personelit ndihmës mësimor–artistik-shkencor, rishikohet ngarkesa e stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme apo bëhet dhe rishikimi i programeve të lëndëve, nëse është e nevojshme. Trajtohen problematikat e zgjidhjet e duhura për secilën njësi bazë në lidhje me zhvillimin e procesit mësimor si dhe të personelit administrativ. Marrëdhënia midis Departamenteve është bashkëpunuese pasi programet që ofrohen në FAS janë të lidhura me njëra tjetrën dhe plotësojnë njëra tjetrën në kompleksitetin e realizimit të programeve të studimit.</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | Konstatojmë se ky Institucion vit pas viti ka bërë progres në realizimin e objektivave në procesin mësimor duke vendosur dhe konsoliduar marrëdhënie bashkëpunimi në fushën e edukimit dhe kërkimit artistik shkencor me shumë universitete dhe institucione në Evropë. Bashkëpunimi evidentohet në dosjen e vetëvlerësimit por edhe sipas pohimit të anëtarëve të Grupit të Vlerësimit të Brendshëm dh zyrës së projekteve me të cilët GVJ organizoi takimin.<br><br>Disa nga këto marrëveshje me këto institucione janë:<br>- Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Conservatoire Nacional Supérior de Musique et de Danse de Paris dhe UART;<br>- Marrëveshje Kuadër ndërmjet UART dhe Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë, Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim;<br>- Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet UART dhe Festivalit të Filmit në Shkup CINEDAYS;<br>- Memorandum Mirëkuptimi midis Zhejiang Normal University in Jinhua, Zhejiang, China;<br>- Protokoll i Bashkëpunimit të UART të Bukura "Mimar Sinan" dhe UART,<br>- Universitetin "Aleksandër Moisiu" - Durrës;<br>- Universitetin 'Luigj Gurakuqi' - Shkodër;<br>- Shkollën kombëtare artistike "Jordan Misja".<br><br>*(Evidencë Dosja e Vetëvlerësmit, Evidenca Nr. 2.13 dhe 2.14)*<br><br>Prandaj, GVJ kontaton se FAS i jep një rëndësi të veçantë pjesëmarrjes në bashkëpunime ndërkombëtare të cilat kanë mundësuar mobilitetin e studentëve, për të gjitha ciklet e studimeve, dhe të stafit akademik me kohë të plotë. |
| **Kriteri 3.** Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave | GVJ dëshmon se për realizimin e programit të studimit UART ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi për studentët që mbarojnë studimet në këtë Institucion. Ashtu siç është e paraqitur edhe në RVB, për mbështetjen e studentëve janë lidhur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me: Këshillin e Qarkut Tiranë, Radio Televizionin Shqiptar, Teatrin Kombëtar, Teatrin Kombëtar të Operës dhe Baletit, Universitetin e Tiranës, Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës; Universitetin "Luigj |

| | |
|---|---|
| profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademikt dhe studentëve. | Gurakuqi' Shkodër; Shkollën kombëtare artistike "Jordan Misja", Teatrin e Metropolit, etj. Ashtu siç na u tha edhe gjatë vizitës në FAS, synimi i këtij Fakulteti është dhënia e hapësirave të duhura studentëve për të realizuar projektet e tyre vjetore në këto institucione, të mbështetur edhe nga pedagogët udhëheqës të tyre, duke u dhënë njëherazi mundësinë që të jenë edhe në kontakt me profesionistë të fushës dhe të ndjekin nga afër edhe proceset krijuese në intitucionet e mësipërme duke u ofruar një laborator të vërtetë pune. |
| **Kriteri 4.** Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. | GVJ u informua se një rol të veçantë në UART luan bashkëpunimi me Zyrën e Zv. Rektorit për anën mësimore me Drejtoritë apo sektorët e tjerë të UART, duke përgatitur raporte me përmbledhje të dhënash lidhur me arritjet akademike dhe sidomos kërkimin artistiko - shkencor lidhur me programin e studimit, duke përcaktuar edhe objektiva për të ardhmen si dhe elementë që duhen përmirësuar e avancuar.<br><br>GVJ u njoftua se të gjitha të dhënat në lidhje me programin e studimit dhe aktivitetet përkatëse, përpunohen prej zyrave përkatëse dhe publikohen në raportin vjetor të Fakultetit si dhe në Raportin Vjetor që institucioni (UART) përgatit për MAS.<br><br>*(Evidenca 2.15 - Aktivitetet e përbashkëta të pedagogëve dhe studentëve në 3 vitet e fundit); (Evidenca 2.16 - Raport mbi marrëveshjet e bashkëpunimit)* |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se UART në përgjithësi dhe FAS në veçanti, ka siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të kërkimit artistiko – shkencor, atij profesional dhe mobilitetit të studentëve dhe stafit akademik.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

| **Standardi II.1**<br><br>**Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Bazuar në planin mësimor - Programi i studimit Master i Arteve në "Aktrim dhe Mësuesi", GVJ konstatoi se programi është i organizuar në lëndë e module të vlerësuara në kredite në përputhje me Ligjin Nr.80/2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).<br><br>Forma e studimit për këtë program është me kohë të plotë dhe realizohet për 2 vite akademike me nga 2 semestra secili. Përfundimit të këtij programi studimesh i korrespodon grumbullimi i 120 krediteve ECTS, duke realizuar çdo vit 60 kredite.<br><br>Referuar planit mësimor lëndët janë të ndara si më poshtë:<br>- Lëndët bazë – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme;<br>- Lëndë karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore-artistike;<br>- Lëndë ndërdisiplinore/Integruese – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje;<br>- Lëndë me zgjedhje dhe Lëndë plotësuese – gjuhë e huaj, njohuri informatike, praktika profesionale;<br>- Detyrime përmbyllëse – diploma; |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të | Programi i studimit Master i Arteve në Aktrim dhe Mësuesi" i korrespodon Nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve duke fituar njohuritë, afësitë dhe kompetencat për të mundësuar |

| | |
|---|---|
| përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | punësimin si (*Ev. Rregullore e programit MA në Aktrim dhe Mësuesi, neni 40)*:<br>- Aktor në të gjitha gjinitë e teatrit<br>- Aktor ne teatër kukullash dhe marionete,<br>- Aktor evenimentesh: kulturore, sociale, politike, etj<br>- Drejtues artistik i institucioneve artistike, teatrore dhe kulturore, etj<br>- Aktor në teatrot e edukimit në shkolla<br>- Aktor i të gjitha gjinive të filmit<br>- Aktor në televizione<br>- Mësimdhënës, në shkolla 9 vjeçare ose të mesme<br>- Menaxher arti<br>- Kritik arti, etj<br>GVJ është i mendimit se njohuritë e përftuara në këtë cikël studimi krijojnë arritje dhe shprehi të veçanta për të ushtruar një profesion dhe një specialitet të lidhur me fushën e aktrimit. |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. | Duke iu referuar Rregulores së progranit të studimit si dhe planit mësimor të tij, GVJ konstaton se lëndët që përfshihen në kurrikulën e këtij programi studimi janë të organizuara sipas kategorive (A-E), në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL" i ndryshuar Ngarkesa totale për një vit akademik është 60 kredite. (*Evidenca 1.7*).<br>Në këtë program studenti merr:<br>- Për lëndët e kategorisë A, 28 kredite;<br>- Për lëndët e kategorisë B, 46 kredite;<br>- Për lëndët e kategorisë C, 12 kredite;<br>- Për lëndët e kategorisë D, 14 kredite;<br>- Për detyrimin përmbyllës të kategorisë E, që është diploma, 20 kredite;<br>Një krediti i korespondon 25 orë mësimore punë e studentit, përbërë nga orë mësimore për transmetim dijesh në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës) dhe orë mësimore për përgatitje ose punë individuale të studentit. Ngarkesa totale për |

| | |
|---|---|
| | një vit akademik është 60 kredite.<br>GVJ ju komunikua se Praktika profesionale ka si qëllim aftësimin e studentëve në procesin e mësimdhënies. Praktika zhvillohet në marrëveshje me Drejtoritë Arsimore Rajonale ku studentëve u përcaktohen shkollat ku ata do të kryejnë praktikën. Praktika realizohet në dy vite duke u shtrirë përkatësisht në tri javë për çdo vit akademik me një total vjetor prej 150 orësh në auditor. Referuar edhe Rregullores së programit të studimit, në fund të dy viteve studenti vlerësohet me notë edhe nga pedagogu i caktuar nga FAS për mbikqyrjen e praktikës mësimore. Ky proces i jep mundësinë studentit të përfitojë një total prej 6 kreditesh në të dy vitet (3 në çdo vit). *(Evidenca 3.3 Dosja e Praktikës Profesionale)*<br>*(Evidenca 3.1 .Plani mësimori i Programit të Studimit Master)* |
| **Kriteri 4.** Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit. | GVJ gjatë takimit në Institucion Ju tha nga disa burime se Programet e studimit të ciklit të dytë të ofruara në UART në të tre fakultetet e tij, jan programe që ofrohen të gjitha edhe në fushën e Mësuesisë. Priotiteti i riorganizimit të këtyre programeve është mundësia për ti ofruar studentëve të drejtën e punësimit edhe në fushën e mësuesisë, përveç fushës specifike në të cilën ato studiojnë, siç është Aktrimi në këtë program studimi. GVJ ju tha se Studimet e ciklit të dytë në Master i Arteve në Aktrim dhe Mësuesi janë vazhdim i studimeve të mëtëjshme të njohurive të marra nga studentët në ciklin e parë Bachelor në Aktrim. Pranimi i kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë, Master i Arteve, bëhet me konkurs. GVJ ju komunikua se me konkurs, zhvillohen të gjitha programet e studimit të ciklit të parë Bachelor por edhe proramet e Ciklit të dytë Master i Shkencave dhe Master Profesional që ofrohen në një Fakultet tjetër të UART, në Fakultetin e Muzikës.<br>*(Evidenca 1.15..Statuti i UART)*<br>*(Evidenca 2.5 Rregullorja e Programit të Studimit Master)* |
| **Kriteri 5.** Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të | Siç e theksuam edhe në kriterin e mësipërm, programet e studimit të ciklit të dytë në UART janë riorganizuar për tu ofruar edhe në fushën e mësuesisë, kjo për ti ardhur në ndihmë studentëve për t'u përafruar sa më shumë me tregun e punës. Riorganizimi i tyre u realizua sipas Urdhrit të MASR Nr. 821, |

| | |
|---|---|
| krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet "Master", që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme. | datë 26.12.2018 "Për riorganizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë në Universitetin Arteve". *(Referoju Evidencës Nr1.5).* Programet e studimit të ciklit të dytë të cilat përfshijnë edhe fushën e mësuesisë, janë të organizuara me 120 ECTS, me kohëzgjatje 2 vite akademike, në sistemin e studimeve me kohë të plotë (60 kredite për çdo vit akademik).<br><br>Referuar planit mësimor të vënë në dispozicion por edhe shpjegimit nga drejtuesit e FAS, programet e masterit përmbajnë 25% të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik si më poshtë:<br><br>Kategoria A-Lëndë Bazë, 28 ECTS,(në dy vite) nga të cilat lëndët e formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik 24 ECTS:<br><br>- Metodologji e Mësimdhënies – 6 ECTS;<br>- Teoritë e të nxënit & Menaxhimi i klasës – 6 ECTS;<br>- Vlerësimi në arsim – 4 ECTS;<br>- Zhvillim i kurrikulës – 4 ECTS;<br>- Psikologji zhvillimi i moshave – 4 ECTS;<br><br>Kategoria D- Lëndë me Zgjedhje dhe Lëndë Plotësuese, 14 ECTS,(në dy vite) nga të cilat lëndët e formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik 6 ECTS:<br><br>- Praktikë mësimore – 6 ECTS<br><br>Në total lëndët e formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik përmbajnë 30 ECTS, pra 25% të krediteve, në këtë drejtim.<br><br>*(Referuar Evidencës 3.1.Plani mësimori i Programit të Studimit Master)* |
| **Kriteri 6.** Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në | GVJ konstaton nga këqyrja e dokumentave të ngarkuara në system nga UART por edhe nga takimi me Dekanin e Fakultetit dhe Shefin e Departamenit përkatës, se FAS/UART ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe objektivat institucionalë, duke ndjekur politikat e tij për pranimin e studentëve. Universiteti i Arteve si Institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë me karakter akademik, artistik dhe shkencor, me veprimtari në fushën e arteve, që prej datës 10.03.2021 gëzon Statusin e veçantë me VKM Nr 145 "Për dhënien e Statusit të |

| | |
|---|---|
| kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin. | veçantë UART, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë".<br>Statusi i veçantë UART-së i është dhënë për trajtimin e veçantë për efekt mësimdhënie, veprimtarie akademike, organizimi akademik, organizimi të programeve të studimit, etj<br>Panvarësisht nga marrja e statusit të veçantë, forma e organzimit të studimeve në UART, është sipas përcaktimit ligjor dhe janë studime që ofrohen me kohë të plotë.<br>Pranimi i studentëve në ciklin e dytë të studimeve bëhet me konkurs, kriteret e të cilave hartohen nga Departamentet, miratohen në Senatin Akademik të UART dhe dërgohen në MAS. Pranimi i studentëve me konkurs është e përcaktuar në Statutin e UART (Neni 92, pika 1), por edhe në Rregulloren e FAS, në Rregulloren e Departamentit Aktrim dhe në Rregulloren e Programit të Studimit Master i Arteve në Aktrim dhe Mësuesi (neni 11, pika 1).<br>Tarifat e shkollimit për secilin program studimi të ofruar në UART përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.<br>*(Evidencë 3.7. Rregullorja për zhvillimin e konkursit për vitin akademik 2020-2021 dhe kriteret e miratuara me vendim Senati të dy cikleve të studimit 2020- 2021)*<br>*(Evidencë 3.10 kapacitetet pritëse të Aktrim/FAS)* |
| **Kriteri 7.** Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind. | Universiteti i Arteve është institucioni i vetëm publik që ofron programe në fushën e artit skenik, arteve të bukura dhe në fushën e muzikës. Si i tillë, programi i studimit objekt vlerësimi i GVJ nuk ka përafrim me ndonjë program tjetër të kësaj fushe, pasi nuk ka program me të njëjtin emërtim që të ofrohet në ndonjë institucion tjetër të arsimit të lartë publik apo privat. |
| **Kriteri 8.** Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet | Referuat RVB por edhe sqarimit me Grupin e Vlerësmit të brendshëm, GVJ konstaton se programi i Studimit të ciklit të dytë Master i Arteve në Aktrim dhe Mësuesi shoqërohet me kodin përkatës sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike me anë të VKM Nr. 310, datë 11.05 2022 "Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në republikën e Shqipërisë" |

| | |
|---|---|
| kodifikimi i lëndëve të programit. | Programi i Studimit të ciklit të dytë Master i Arteve në Aktrim dhe Mësuesi sipas pikës 2, germa e), është Master i Arteve, jo më pak se 120 ECTS me kodin **72 MA**.<br>Fusha e gjerë e Programit të Studimit është ajo 02 – Arte dhe Shkenca Humane.<br>Fusha e ngushtë e Programit të Studimit është: 021 – Arte.<br>Fusha e detajuar e Programit të Studimit është: 0215 – Arte Muzikore dhe Performimi.<br>Gjuha në të cilën ofrohet Programi i Studimit është shqip (S).<br>*(Evidencë 2.9 Specifikimet dhe Përmbajtja e Programeve të Studimit)* |
| **Kriteri 9.** Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. | Programi i studimit nuk ofrohet si program i përbashkët me ndonjë institucion tjetër të arsimit të lartë.<br>Programi ofrohet nga Departamneti Aktrim dhe Teori, Fakulteti i Artit Skenik, Universiteti i Arteve. |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se programi i studimit Mastër i Arteve në "Aktrim dhe Mësuesi" ofrohet në përputhje me Ligjin e Arsimit të lartë Nr 80/2015, aktet nënligjore që rrjedhin prej tij si dhe në përputhje me aktet rregullative të Fakultetit të Artit Skenik dhe Departamentit përgjegjës, Departamenti Aktrim dhe Teori.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.2**<br>**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit | Institucioni UA ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik. Ky vlerësim u finalizua me |

përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 17, datë 24. 03. 2022 që e akrediton institucionin për 6 vite akademike.
Fakulteti i Artit Skenik (FAS) si njësia kryesore është i organizuar në 3 njësi bazë të cilat plotësojnë kërkesat ligjore në fuqi për sa i përket numrit të stafit akademik dhe kritereve të kualifikimit shkencor të tij.

Aktualisht FAS ofron programe të studimeve të të tre cikleve të studimit, ciklit të parë bachelor (5 programe); ciklit të dytë master i Arteve (5 programe) dhe doktoratë (1 program). Programet e tre cikleve ofrohen në përputhje me objektivat e tij akademikë dhe Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve.

FAS organizohet në tre njësi bazë, si më poshtë:,

- Departamenti Aktrim dhe Teori;
- Departamenti Regji, dhe Regji Filmi & TV;
- Departamenti Skenografi-Koreografi;

Referuar dokumentit të marrë gjatë vizitës në institucion (*Tabela Nr. 1 FAS per tre vite akademike 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022)* rezulton se numri i stafit akademik me kohë të plotë i ndarë sipas Departamenteve (2021-2022) paraqitet si më poshtë:

1. Departamenti Aktrim dhe Teori; – 17 pedagogë;
2. Departamenti Regji, dhe Regji Filmi & TV – 16 pedagogë;
3. Departamenti Skenografi-Koreografi 11 pedagogë;

Departamenti i Aktrim dhe Teori, i përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë: *(Tabela Nr. 2 Aktrim dhe Teori)*

| Tituj/ grada | **2021-2022** | | **2020-2021** | | **2019-2020** | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | PAE | PAK | PAE | PAK | PAE | PAK |
| Prof.Dr. | 4 | 1 | 5 | - | 5 | - |
| Prof. Asoc.Dr | 3 | - | 3 | - | 4 | - |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Dr./PhD. | 6 | 4 | 5 | 5 | 5 | 5 |
| Msc. | 3 | 2 | 3 | 5 | 3 | 2 |
| **Totali** | **16** | **7** | **16** | **10** | **17** | **7** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj. | Gjatë takimit me drejtuesit e Fakultetit të Artit Skenik, GVJ ju komunikua se në kuadër të FAS funksionojnë struktura ndihmëse me karakter akademik/administrativ, të cilat përcaktohen në strukturën dhe në Rregulloren e këtij Fakulteti.<br>Struktura administrative dhe ndihmës akademike në FAS përbëhet si më poshtë vijon:<br>▪ Struktura ndihmës akademike me karakter administrativ:<br>- Sekretaria e FAS;<br>- Kryesekretarja e FAS;<br>- Specialisti për kurrikulën dhe informimin e studentëve;<br>• Struktura administrative:<br>- Kryetari i Degës së FAS<br>- Punonjësit e shërbimit.<br>- Struktura ndihmës akademike me karakter akademik:<br><br>Personeli ndihmës akademik i FAS angazhohet për të vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën e nevojshme të tij në funksion të realizimit të programeve mësimore.<br>Në Departament bashkëngjitet kurdo që është e nevojshme edhe Kryetarja e Degës në FAS përgjatë aktivitetit të përditshëm mësimor dhe në mënyrë të pandërprerë edhe përgjatë periudhës së provimeve. *(Evidenca 2.3.Rregullorja FAS); (Evidenca.1.15.Statuti i UART).* |
| **Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe | Gjatë bisedës me përgjegjësin e Departamentit GVJ mësoi se progamet e studimit janë të organizuar në grupe mësimore. Përgjegjësit e grupeve mësimore janë përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin programit në përputhje me objektivat e tij. Gjithashtu na u komunikua se në Departamentin e Aktrimit dhe Teori, është ngritur grupi mësimor, ai Programit të Studimit Aktrim dhe Mësuesi. Koordinatori i Programit të Studimit emërohet me vendim të Dekanit të FAS. Kordinatori është anëtar i Personelit Akademik në FAS ose Departament.<br>Përgjithësisht rolin e koordinatorit të Programit të Studimit e |

| | |
|---|---|
| praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | luan pedagogu që është caktuar edhe kryetar i grupit mësimor për këtë program studimi.<br>*(Evidencë 2.4.Rregullore Departamentit Aktrim)*<br>*(Evidencë 3.1.Drejtuesit e grupeve mësimore në FAS)* |
| **Konkluzione** | *GVJ konkludon se Njësia kryesore, Fakulteti i Artit Skenik dhe Njësia bazë përgjegjse për ofrimin e programit Master i Arteve në "Aktrim dhe dhe Mësuesi" përmbush kërkesat ligjore dhe standardet për këto Njësi.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.3**<br>**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. | GVJ konstatoi se programi i studimit Master i Arteve në "Aktrim dhe Mësuesi" paraqitet i detajuar në elementët e tij që përfshijnë:<br>- Planin mësimor;<br>- Rregulloren e programit të studimeve;<br>- Programet (syllabuset) e lëndëve;<br>- Modelin e diplomës.<br>- Suplementin e diplomës<br>Ky informacion i shoqëruar me kuotat dhe kriteret e përvitshme të pranimit si dhe me Rregulloren e konkurseve të pranimit, përbëjnë informacionin bazë të programit të studimit, i cili disponohet nga Departamenti dhe që vihet në dispozicion të studentëve.<br>*Evidencë Planet mesimore tw programit; Rregullore e programit MA në Aktrim dhe Mësuesi; Programet e Lëndëve* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm | Plani mësimor si elementi bazë i programit të studimit përmban:<br>- Ndarjen e lëndëve sipas viteve dhe semestrave;<br>- Ndarjen e lëndëve sipas aktiviteteve formuese; |

| | |
|---|---|
| për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. | - Dhënien për secilën lëndë të ngarkesës në kredite dhe numrit të orëve në auditor;<br>- Ndarjen e ngarkesës në auditor për secilën lëndë në elementët përbërës si leksione, seminare, laboratorë, projekte etj.<br>Në Rregulloren e programit të studimit përcaktohen edhe elementë që lidhen me shkallën e detyrueshme të frekuentimit, mënyrën e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve, përmirësimin e notave, mënyrën e diplomimit etj.<br><br>*(Evidencë Rregullore Mësimore e Programit të Studimit MA në Aktrim dhe Mësuesi).* |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | Të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të krediteve jepen në Rregulloren Mësimore të Programit të Studimit Master i Arteve në "Aktrim dhe Mësuesi" dhe në Rregulloren e Fakultetit të Artit Skenik. Këto informacione mund të aksesohen edhe nëpërmjet faqes WEB të institucionit. GVJ është i mendimit se praktikat e prezantuara për transferim studimesh dëshmojnë për procedura të qarta dhe transparente të zbatuara nga institucioni.<br>*(Evidencë Rregullore Mësimore e Programit të Studimit MA në Aktrim dhe Mësuesi)* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | Elementë më të detajuar për lektorin apo lektorët që do të zhvillojnë lëndën, semestrin kur zhvillohet, njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti, elementët e mësimdhënies, detyrimet për frekuentimin, literaturën, mënyrën e shlyerjes së lëndës dhe peshën e elementëve të ndryshëm në vlerësimin final jepen në syllabuset e lëndëve. *(Evidencë Programet e Lëndëve).*<br><br>GVJ është i mendimit se syllabuset e lëndëve, përmbajnë përgjithësisht të gjithë elementët e nevojshëm të përcaktuar në VKM Nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë", si dhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë". |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht. | Nga studimi i DVV dhe takimet në institucion, GVJ konstatoi se që nga riorganizimi i programeve duke u ofruar edhe në fushën e mësuesisë, nuk ka pasur ndryshime në planin mësimor të programit të studimit. Ndryshimet dhe përmirësimet kanë konsistuar kryesisht në rishikimin e syllabuseve të lëndëve, ku janë pasqyruar elementë që lidhen me zhvillimet dinamike në fushën e regjisë.<br>*(Evidencë Takim me përfaqësues të Sektorit Mësimor dhe Kurrikulave)* |
| **Konkluzione** | *Bazuar në takimin me Përfaqësues të Sektorit Mësimor dhe Kurrikulave, në Evidencën e Programeve të Lëndëve, Rregulloren Mësimore të Programit të Studimit MA në Aktrim dhe Mësuesi, Planet mesimore të programit MA në Aktrim dhe Mësuesi, GVJ gjen se* ***Programi i studimit është i mirëstrukturuar, i detajuar dhei nformues dhe është organizuar në përputhje me objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.*** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.4**<br>**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. | GVJ pas shqyrtimit të DVV dhe kryesisht pas shqyrtimit të Rregullore së programit të studimit, shprehet se përmbajtja e këtij programi u jep mundësinë studentëve që të zhvillojnë një përvojë të pavarur krijuese dhe artistike duke i përgatitur studentët për trajnime të mëtejshme. *Sipas nenit 8* të rregullore së programit, qëllimi është që studenti të zhvillojë dhe të thellojë punën e tij në lidhje me zgjedhjen e materialeve, metodën dhe interpretimin dhe që të zhvillojë një njohje optimale me vendosjen e konteksteve artistike bashkëkohore dhe artistike. |

| | |
|---|---|
| | GVJ gjatë takimit në institucion ju tha se studenti në programin e studimit është i mbështetur nga pedagogët për të ndjekur zhvillimin e punës artistike si dhe për të mbështetur projektin artistik në përgatitjen e një eseje me një temë në lidhje me praktikën artistike.<br><br>Nga takimi me studentët e programit të studimit GVJ u informua se numri më i madh i tyre shprehin interesim për të vazhduar studimet në ciklin e tretë, përderisa një pjesë të tyre ishin në bisedime për të filluar punë sapo të mbaronin studimet. Hapësira që i jepet studentit në punën artistike aktoriale por edhe asaj teorike dhe pedgogjike i ndihmon ata që të mund ti përdorin këto njohuri aty ku do të mund të punësohen. *(Evidencë Takime me studentët e programit; RVB).* |
| **Kriteri 2.** Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. | Nga vlerësimi i planit mësimor (*Evidencë Planet mësimore të programit MSE 2021 - 2022, 2020 - 2021, 2019 – 2020)*, GVJ konstatoi se shpërndarja e lëndëve të programit të studimit në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional në fushën e Aktrimit.<br><br>Referuar RVB por edhe Rregullores së programit të studimit Master i Arteve në Aktrim dhe Mësuesi, *Objektivat kryesore të programit janë :*<br><br>- *specializim të njohurive të studentëve krahasuar me programin e studimit të ciklit të parë në fushën e aktrimit, qoftë në zhanre a stile të ndryshme aktoriale;*<br>- *përgatitje të avancuar të tyre për formimin e kompetencave dhe aftësive që iu korrespondojnë nivele të kualifikuara të punësimit dhe të profesionalizmit në fushën e aktrimit të teatrit dramatik, të filmit, të aktrimit në çdo lloj spektakli tjetër skenik përfshirë këtu edhe aktrimin në teatër, film e spektakël televiziv;*<br>- *trajnim për kërkim të pavarur nëpërmjet njohjes së metodave, instrumentave e teknikave të krijimit dhe kërkimit në aspekte që kanë të bëjnë me aktrimi, dramaturgjinë, teatrologjinë, kritikën teatrore, regjinë, pedagogjinë, stilet edhe shkolla të ndryshme të krijimit aktorial etj.* |

| | |
|---|---|
| | Sipas Rregullores së programit mësimor, *neni 8*, studimi në ciklin e dytë është i integruar dhe kryhet nëpërmjet gjithëllojshmërisë së procesit metodiko – pedagogjik dhe lëndët integruese si Aktrim 1, Aktrim 2, Fjala Artistike, Interpretimi i Aktorit në film, etj Integrimi nënkupton faktin e procesit të përfshirjes së lëndëve me drejtim pedagogjik së bashku me lëndët formuese profesionale artistike.<br><br>Po sipas *nenit 8* të Regullores, Studimi në master thekson atë që student të bëhet artist interpretues dhe krijues, duke u fokusuar në hartimin dhe konceptimin e performancës, realizimin e hapësirave reale dhe virtuale të teatrit, të operës, të filmit, të televizionit, të mjediseve, të hapësirave publike të komunikimit komerciale dhe institucionale artistike kulturore, etj me efekte komunikuese emocionale. *(Evidencë Rregullorja e programit të studimit)* |
| **Kriteri 3.** Struktura e programit, lëndët, raporti teori - praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional. | Organizimi i Programit të Studimit Master i Arteve në Aktrim dhe Mësuesi, është hartuar duke u konsultuar/konsideruar programe të ngjashme ndërkombëtare si dhe përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës dhe Sistemit Europian të Transferimit dhe Mbledhjes së Krediteve (ECTS). Duke qenë se Programi i studimit është në përputhje me kriteret, parimet e standardet europiane, studentët e FAS – Aktrimit, të cilët kanë kryer mobilitete në universitete të huaja e kanë patur shumë të lehtë integrimin në programet respektive të tyre<br><br>*(Evidencë Takimi me studentët).*<br><br>*(Evidencë 3.2.Kurrikula e Programit të Studimit Master).* |
| **Kriteri 4.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | GVJ është i mendimit se ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. Personeli akademik si dhe studentë të cilët kanë përfituar mobilitete në institucione analoge jashtë vendit në programe të ngjashme kanë konstatuar një përputhje të mirë të këtij programi studimi me programe analoge. Objektivat strategjikë të UART kanë si prioritet: mobilitetet, aktivitetet artistike kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe rritjen |

| | |
|---|---|
| | dhe konsolidimin e partneritetit me vende të BE-së.<br>*(Evidencë 3.1 Plani mësimor i Programit të Studimit Master)* |
| **Kriteri 5.** Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit. | Gjatë takimeve në institucion GVJ, në kuadër të rritjes së cilësisë së mësimdhënies, GVJ ju komunikua se literatura bazë dhe e rekomanduar e përfshirë në syllabus, përditësohet duke përfshirë literaturën e cila është në qarkullim në 5 vitet e fundit.<br>GVJ iu komunikua se programet e lëndëve rishikohen çdo fillim viti akademik nga titullari/pedagogu i lëndës, bëhen konsultime mes anëtarëve të departamentit dhe se ato miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit. GVJ konstaton se Syllabuset e të gjitha lëndëve në këtë program studimi janë në përputhje me përcaktimet të VKM 41 datë 24.01.2018 i ndryshuar, i rishikuar duke filluar me pasqyrën informative të lëndës, rezultatet e të nxënit, konceptet themelore, temat e detajuara të lëndës, format e kontrollit të dijeve, frekuentimi, kontrolli i vazhdueshëm, literatura dhe në fund vërejtje përfundimtare nga pedagogu.<br>*(Evidencë 3.2..Kurrikula e Programit të Studimit Master).*<br>*(Evidencë 3.15.Lista e tiujve në Bibliotekën e UART)* |
| **Kriteri 6.** Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. | Përmbajtja e Programit të Studimit Master i Arteve në "Aktrim dhe Mësuesi' garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për një program studimi të ciklit të dytë. Nga takimet me studentët rezulton se realizimi faktik i programit të studimit është brenda pritshmërive të tyre.*(Evidencë Takim me studentët)* |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | Referuar DVV dhe takimeve në institucion, GVJ është i mendimit se përmbajtja e programit të studimit garanton si punësimin mbas diplomimit ashtu edhe vazhdimin e studimeve të ciklit të tretë. Një pjesë e studentëve të diplomuar në këtë program studimi punësohen si brenda apo edhe jashtë vendit. Ka dhe prej tyre që janë punësuar në institucion, duke siguruar qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e mëtejshëm të programit. Një pjesë e studëntëve janë të punësuar në: Teatrin Kombëtar, Teatrin Kombëtar Eksperimental, Radio Televizionin Shqiptar, Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit, Teatrin e Metropolit, si dhe në shumë radio televizione kombëtare dhe lokale. (*Evidencë RVB, Takime në institucion)*. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, në përputhje me kërkesat e tregut të punës.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi II.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. | Mbështetur në RVB, Departamenti i Aktrimit dhe Teorisë ka kryer edhe vlerësime periodike të programeve të studimit për të parë ecurinë e tyre si dhe përputhjen me nevojat e tregut.<br>UART - Fakulteti i Artit Skenik, nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit me partnerë të ndryshëm nga tregu i punës si dhe nëpërmjet projekteve që lidhen me punësimin apo aktivitete të organizuara në lidhje me studentët dhe tregun e punës, kanë synuar nga njëra anë përshtatjen sa më të mirë të programit të studimit me kërkesat e tregut e punës dhe nga ana tjetër ofrimin dhe njohjen e studentëve me këtë treg. GVJ konstaton se vlerësimi i programeve të studimit të ofruara nga Fakulteti i Artit Skenik është kryer duke analizuar përputhshmërinë me objektivat dhe strategjinë e zhvillimit, treguesit e matshëm, zhvillimin e programeve të studimit dhe vlerësimin, analizuar të dhëna për studentët pas diplomimit, si dhe duke formuluar gjetje dhe rekomandime. |
| **Kriteri 2.** Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, | GVJ konstaton se një pikë e fortë e FAS është fakti se studentët përfshihen në përmirësimin e programit të studimit, nëpërmjet marrjes së mendimit të tyre. Kjo realizohet me anketimet e kryera. Një nga pyetsorët e studentëve i kushtohet vlerësimit të programit të studimit dhe personelit akademik (*Evidencë Model* |

| | |
|---|---|
| për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. | *Pyetesori).* Kjo shërben si bazë për propozime eventuale për përmirësime aty ku lind e nevojshme.<br><br>Në takimin me Dekanin e Fakultetit të Artit Skenik u theksua se puna me kurrikulat është një proces i vazhdueshëm. Referuar dokumentacionit të paraqitur, GVJ konstaton se nuk ka patur gjatë tre viteve të fundit përmirësime në kurrikulën e programit të studimit, por vetëm në syllabuset e lëndëve duke bërë përshtatjen me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.<br><br>*(Evidencë RVB; Takim me Dekanin dhe Koordinatorin e Programit).* |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private. | FAS / Aktrimi nisur nga natyra e veçantë që ka, natyrshëm i ka dhënë rëndësi të madhe bashkëpunimit me instanca të tjera për ofrimin e shërbimeve të studentëve të tij.<br><br>GVJ, në këtë kuadër konstaton se janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me: Teatrin Kombëtar, Teatrin e Metropolit, Radio Televizionin Shqiptar, Këshillin e Qarkut Tiranë, Teatrin Kombëtar të Operës dhe Baletit, Universitetin e Tiranës, Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës; Universitetin 'Luigj Gurakuqi' Shkodër; Shkollën kombëtare artistike "Jordan Misja", etj, duke bërë të mundur plotësimin e nevojave të studentëve për funksionimin dhe realizimin e programit të studimit. Një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi janë realizuar edhe në kuadër të publikimit "Pakti për Universitetin". |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se UART nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin e tij në përputhje me objektivat e tyre.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.6**<br><br>**Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. | Referuar jo vetëm DVV por edhe bashkëbisedimit të realizuar gjatë vizitës së GVJ në Institucion, shprehemi se objektivat e programit të paraqitura në Regulloren e programit të studimit, janë në unison me objektivat madhore të institucionit të pasqyruar si në Statutin e UART ashtu edhe në Rregulloren e UART, i cili ka qëllim krijimin, zhvillimin, përçimin e dijeve përmes mësimdhënies, në fushën e artit dhe të kulturës si dhe nxitjen dhe zhvillimin e kërkimit artistiko – shkencor; formimin e specialistëve të lartë në fushat e arteve dhe përgatitj e artistëve të rinj në përputhje me prioritet e zhvillimit të vendit.<br>Për sa më sipër është në koherencë me objektivat e programit të, të përcaktuara në Rregulloren e programit të studimit, neni 2. Këto objektiva janë:<br>▪ *specializim të njohurive të studentëve krahasuar me programin e studimit të ciklit të parë në fushën e aktrimit skenik;*<br>▪ *përgatitje të avancuar të tyre për formimin e kompetencave dhe aftësive që iu korrespondojnë nivele të kualifikuara të punësimit dhe të profesionalizmit në fushën e aktrimit të teatrit dhe të filmit, në spektakël skenik a televiziv dhe në të zhanret dhe stilet e mjeshtërisë së aktrimit;*<br>▪ *trajnim për kërkim të pavarur nëpërmjet njohjes së metodave, instrumentave e teknikave të krijimit dhe kërkimit në aspekte që kanë të bëjnë me aktrimin, dramaturgjinë, teatrologjinë, regjinë, kritikën teatrore, pedagogjinë, stilet edhe shkolla të ndryshme të krijimit aktorial, etj;*<br>*Evidencës 2.5 Rregullorja e Programit të Studimit Master Evidencës 1.15.Statuti i UART neni 4, 7* |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit | Departamenti i Aktrim dhe Teori, si njësia bazë në të cilën ofrohet ky program studimi ka si mision të tij nxitjen, programimin, bashkërendimin, zhvillimin, organizimin dhe administrimin e veprimtarisë së mësimdhënies dhe asaj artistiko – kërkimore – shkencore. *(Rregullorja e Deparatmentit Aktrim dhe Teori, neni 3)*<br>Ky Deparatment promovon zhvillimin e studimit, procesit mësimor artistik dhe të kërkimit shkencor, bashkëpunimin ë |

| | |
|---|---|
| akademik dhe fushën e veçantë të studimit. | shkallë të gjerë me institucioinet e arsimit të lartë dhe të kulturës *(rregullorja e programit neni 4),* bashkëpunime të cilat kanë sjellë edhe një hapje ndaj komunitetit artistik.<br><br>Bashkëveprimi pedagog student si dhe liria akademike janë nga prioritet jo vetëm të këtij Deparatmenti por edhe dy departamenteve të tjera, pjesë të FAS. GVJ gjatë takimit me Shefin e GVJ u dhanë shembuj të veprave të realizuara në periudhën para dhe pas pandemisë globale të Covid 19, ku aktorë dhe regjisorë, pedagogë dhe studentë të Departamentit të Aktrimit/FAS kanë qenë krah përkrah në realizimet më të fundit skenike që i janë prezantuar publikut.<br><br>*(Evidencës 1.15.....Statuti i UART neni 54, 116, 117, 118)*<br><br>*(Evidencës 2.3...Rregullorja FAS)*<br><br>*(Evidencës 2.5 Rregullorja e Programit të Studimit Master)*<br><br>*(Takimi me Shefin e Dep të Aktrimit dhe Teorisë)* |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. | Ashtu siç është paraqitur edhe në Rapotin e vetëvlesimit, raport i cili u konfirmua krejtësisht edhe gjatë viztës që GVJ kreu në Institucion, Programi i Studimit Master i Arteve në "Aktrim dhe Mësuesi", nxit dhe motivon studentët të përfshihen në studime dhe projekte apo aktivitete artistike. Kjo realizohej nëpërmjet disa mënyrave si:<br>- plani mësimor parashikon që detyrimet semestrale studentët t'i realizojnë në formë veprash skenike (fragmente apo pjesë të plota) në skenë pa lënë pas dore detyrimet për lëndët e tjera formuese;<br>- duke nxitur për të marrë pjesë në aktivitete artistike brenda institucionit ose jashtë tij, jashtë detyrimeve semestrale;<br>Edhe gjatë takimit në Institucion, GVJ ju komunikua se pedagogët udhëheqës motivojnë dhe nxisin studentët të hulumtojnë mbi tema të ndryshme në fushën e artit dhe aktrimit që lidhen me interesat dhe prirjet e tyre. Studentët e këtij programi studimi, si pjesë të detyrimeve përmbyllëse, përveç detyrimit artistik, kanë si detyrim përgatitjen e një punimi teorik në fushën e artit (diplomë teorike). Ky punim teorik paraqitet në Departamentin e Aktrimit përpara mbrojtjes artistike të diplomës. Studentët nxiten të marrin pjesë në veprimtari krijuese artistike si shfaqje, variete, evente të fjalës poetike etj. Kjo është pjesë e |

| | |
|---|---|
| | veprimtarive të integruara dhe integruese të Departamentit të Aktrimit për një mësimdhënie gjithëpërfshirëse dhe bashkëpunim krijues.<br>*(Evidencë 1.15.Statuti i UART neni 123)*<br>*(Evidencë 2.5 Rregullorja e Programit të Studimit Master)* |
| **Kriteri 4.** Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme. | GVJ konstaton se UART në strukturën e vet ka vetëm një Drejtori Ekonomike, e cila është në funksion të tre Fakulteteve të UART Referuar Rregullore ssë UART, *neni 45*, peroneli akademik, njësia bazë apo edhe studentët kanë të drejtë të aplikojnë pranë institucioneve kombëtare apo ndërkombëtare për relaizimin e veprimtarisë artistike – kërkimore- hkencore dhe krijuese.<br>Këto të ardhura përbëjnë një zë të veçantë në buxhetin e UART. Në buxhetin që përcaktohet nga Administratori i UART për çdo njësi kryesore, sipas planifikimit të argumentuar, përcaktohet një fond që të mbështesë veprimtarinë artistike – kërkimore – shkencore.<br>*(Evidencë 3.17..Model aplikimi të një projekti)*<br>*(Evidencë 3.18 Dosja e buxhetit të planifikuar nga Drejtoria ekonomike për tre vitet e fundit për UART)* |
| **Konkluzione** | *GVJ shprehet se UART garanton orinetim në fushën e studimeve dhe të kërkimit shkencor.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.7**<br>**Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera | Mbështetur në Rregulloren e Universitetit, takimeve në institucion me drejtuesit kryesor të FAS takimit me stafin akademik por edhe takimin me Komisionin Ad Hoc për sigurimin e cilësisë, GVJ shprehet se ky Institucion kryen veprimtari artistike – kërkimore – shkencore, studime, veprimtari krijuese artistike, të cilat synojnë rritjen e cilësisë së arsimit dhe |

| | |
|---|---|
| kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. | zhvillimin kulturor të vendit.<br><br>Referuar Rregullores së Departamentit Aktrim dh Teori, *Neni 9*, pranë këtij Departamenti ngrihen grupet mësimore-artistike-kërkimore, në përputhje e fushat artistike, mbështetur në grup – lëndët kryesore. Grupi mësimor është përgjegjës për grup-lëndët përkatëse që ofron Programi i Studimit, sikurse edhe lëndët e mbuluara nga stafi i tij akademik edhe në programet e tjera të studimit të ofruara në FAS. Gjatë takimit në institucion GVJ ju komunikua se pedagogët dhe studentët nxiten të marrin pjesë në veprimtari krijuese artistike si në: shfaqje, variete, evente e manifestime të ndryshme të fjalës poetike të organizuara nga vetë ata.<br><br>*(Evidencë 2.3...Rregullorja FAS)*<br><br>*(Evidence 3.19....Procesverbal i Grupit Mësimor Aktrim dhe Teori)*<br><br>*(Evidencës 3.16 Dosja e repertorit të pedagogë/studentëve FAS)* |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave. | Nga takimet në institucion dhe shqyrtimi i DVV, GVJ u informua dhe pati në shqyrtim listën e projekteve në të cilat është i angazhuar institucioni ku marrin pjesë jo vetëm personeli akademik por edhe studentët e ciklit Master. GVJ ju komunikua se Departamenti është i angazhuar në studime e projekte me karakter artistik/kërkimor shkencor duke përcaktuar objektiva të qartë artistike/kërkimore dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave. |
| **Kriteri 3.** Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave. | Aktiviteti artistik i Departamentit të Aktrimit dhe Teori mbështetet si nga Drejtuesit e FAS por edhe të UART. Stafi akademik inkurajohet për të realizuar një aktivitet sa më të dendur dhe cilësor artistiko shkencor. Këto aktivitete i shërbejnë edhe kualifikimit të personelit akademik të kategorisë Asistent Lektor (MSc) për të mundësuar avancimin e tyre në karrierë. Bashkëpunimi staf student është një bashkëpunim i frutshëm dhe tepër i ngushtë. GVJ ju komunikua se shëmbull për këtë ka qënë edhe prezantimi dhe realizimi i veprave të përbashkëta studentë - pedagogë gjatë viteve të fundit, vepra të cilat kanë rezultuar shumë të suksesshme. |

| | |
|---|---|
| | *Evidenca Nr 2.13, 2.14 Marrëveshje bashkëpunimi të UART)*<br>*Evidenca 3.16 Dosja e repertorit të pedagogë/studentëve FAS)* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. | GVJ, nga këqyrja e materialeve të vëna në dispozicion nga DVV por edhe gjatë vizitës në Institucion, vëren se programi i Studimit Master i Arteve në Aktrim dhe dhe Mësuesi, me kohë të plotë që ofrohet nga FAS/UART, është riorganizuar sipas kërkesave të tregut dhe në përputhje të plotë me Procesin e Bolonjës.<br>Në ciklin e dytë të studimeve, studenti në UART dhe konkretisht në programet e ofruara nga FAS, merr njohuri të thelluara në fushën e mësuesisë dhe në specialitetin përkatës, konkretisht në Aktrim me synim formimin artistik.<br>Rishikimi i kurrikulave, sidomos programeve të ciklit të dytë, ashtu si edhe programi në fjalë, ishte realizuar duke pasur parasysh një sërë kërkesash, të shtruara tashmë para shkollës, të cilat i dikton e tashmja dhe e ardhmja e fushës ku veprojmë dhe tregut artistik shqiptar, evropian dhe më gjerë.<br>Për t'u përafruar sa më shumë me tregun e punës, GVJ ju komunikua se Institucionit i lindi nevoja për të riorganzuar të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë në fushën e mësuesisë. Riorganzimi i tyre u realizua sipas Urdhërit të MASR Nr 821, datë 26.12.2018 "Për riorganizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë në Universitetin e Arteve"<br>Pjesë e reformës në FAS është edhe përfshirja e diplomave që lëshon institucioni në profesionet e rregulluara (mësuesi), tashmë si një nevojë e përfshirjes së akteve ligjore për tregun e punën. |
| **Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës. | Nuk aplikohet në këtë program. |
| **Kriteri 6.** Programi i studimit për profesionet e | Programi i Studimit Master i Arteve në Aktrim dhe Mësuesi përfshin jo vetëm pjesën artistike të tij por edhe pjesën |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (*p.sh. Professional QualificationsDirective, 2005/36/EU*). | pedagogjike. Pjesa pedagogjike e këtij programi (Mësuesia) bën pjesë te profesionet e rregulluara dhe është në përputhje me aktet ligjore në fuqi. | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ shprehet se Programi i studimit në Departamentin e Aktrimit dhe Teorisë /FAS garanton njohuri të thelluara qoftë në aspektin krijues artistik, qoftë në atë kërkmiit shkencor. Ky program nxit dhe mundëson ndërkombëtarizimin e vlerave artistike e shkencore.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes sëstandardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| **Standardi III.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, | Nga diskutimi me personelin akademik por edhe me studentët, GVJ ju komunikua se format kryesore të procesit mësimor janë leksionet; seminaret; projekti artistic (projekte në të cilat studentët realizojnë role në shfaqe); kolokiumi; puna individuale me të cilën studenti punon materialet e dhëna nga |

| | |
|---|---|
| detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | pedagogu; detyrat praktike me të cilat studentët paraqiten duke demostruar çfarë kanë fituar nga ana teorike; detyrat e kursit me të cilat pedagogët vlerësojnë studentët në bazë të përvetësimit të lëndës duke ndihmuar në rritjen e aftsive krijuese të tyre Ashtu siç është paarqitur edhe në RVB, GVJ shprehet se format kryesore të vlersimit të studentëve janë provimet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare. Provimet përgjithësisht nuk janë provime standard, por janë vepra konkrete artistike të shpërndara nga pedagogu sipas arritjeve dhe formimit të studentit.<br>*(Evidencë 2.5 Rregullorja e Programit të Studimit Master)*<br>*(Evidencë 3.2.Kurrikula e Programit të Studimit Master)* |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. | Veçori e studimit në Departamentin e Aktrimit dhe Teorisë ashtu si edhe në Fakultetin e Artit Skenik, është gatishmëria e personelit akademik për t'ju përgjigjur studentëve sipas rezultateve të tyre. GVJ ju komunikua se në çdo lëndë mundësohet komunikimi me studentët jo vetëm gjatë realizimit të procesit mësimor në auditor, por edhe jashtë auditorit, qoftë nëpërmjet mbajtjes së konsultimeve me secilin student veç e veç, qoftë nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike (e-mail, etj). Në këtë mënyrë, GVJ konstatoi se personeli akademik ka qenë në vazhdimësi i disponueshëm për zhvillimin e konsultimeve për çështje specifike si dhe për t'ju përgjigjur pyetjeve e shqetësimeve individuale të studentëve në lidhje me procesin mësimor. |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit. | GVJ konstatoi se për të mundësuar përdorimin e metodave të shumëllojshme pedagogjike, institucioni ka marrë masa për të përmirësuar vazhdimisht infrastrukturën në shërbim të studentëve duke ofruar salla/atelie/auditorë të paisur me teknologji bashkëkohore në funksion të mësimdhënies. GVJ ju tha gjatë takimit në Institucion se vazhdimisht në Dekanat në mbledhjet e organizuara, diskutohen mënyrat se si pedagogu i lëndës, duhet të përcjellë tek studentët formën e leksionit apo të orës mësimore. Ashtu siç jemi shprehur edhe më sipër me studentë të ndryshëm punohet me vepra të ndryshme, kjo në varësi të rezultatetve të tyre. Përgjithësisht studentët e këtij programi ishin të kënaqur me marrdhënien që kishin ndërtuar me pedagogët e tyre. (*Takime në institucion*) |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.<br><br>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | GVJ, pasi shqyrtoi CV të stafit akademik vjen në përfundim se fushat e kualifikimit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi përputhen me modulet/lëndët që mbulojnë (*Evidencë. CV e stafit akademik të programit të studimit*).<br><br>Gjithashtu GVJ, nga takimi i zhvilluar me studentët dhe nga rezultatet e pyetësorit të studentëve, konstaton se studentëtë janë të kënaqur nga marrdhënia që kanë ndërtuar me pedagogët e tyre. Transmetimi i njohurive, metodat e ndryshme të mësimdhënies, raporti i krijuar student – pedagog, janë një tregues i fortë që ky program studimi në qendër ka studentët duke nxitur tek ata mendimin krijues, kritik, autonominë dhe përgjegjshmërinë. Programi i studimit mbulohet nga një staf i kualifikuar, pedagogë me një karrierrë të larmishme artitike, pjesa dërrmuese e të cilëve janë emra që kanë lënë gjurmë në kinematografinë shqiptare. Sipas RVB por edhe bisedave në Institucion, në tri vitet e fundit, Departamenti i Aktrimit/FAS, ka angazhuar në këtë program studimi mesatarisht një staf me kohë të plotë me bagazh dhe aktivitet të spikatur artistik jashtë auditorit, duke mbuluar mbi 80% të ngarkesës mësimore bën që në qendër të gjithë procesit të jenë studentët duke nxitur tek ata mendimin krijues, kritik, autonominë dhe përgjegjshmërinë, elemente të domosdoshme këto në procesin e krijimit artistik. (*Takime në institucion*) |
| **Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | GVJ konstatoi se metodat e mësimdhënies janë objekt i diskutimeve dhe vlerësimeve si nga vetë personeli akademik për lëndët që mbulojnë ashtu edhe nga studentët (pyetsorit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies së lëndëve të programit të studimit) si dhe nga drejtuesi i Deparatamentit. Në mënyrë të veçantë përpunimi i të dhënave të pyetsorit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies së lëndëve për çdo program studimi i cili plotësohet në fund të çdo semestri shërben si bazë për përmirësime të mëtejshme. (*Takime në institucion*) |
| **Kriteri 6.** Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të | GVJ gjatë takimeve në Institucion, si me Drejtuesin e FAS, por edhe me stafin akademik dhe Përgjegjesin e Departatmentit, ju bë e ditur fakti se cilësia në mësimdhënie lidhet ngushtë me cilësinë e stafit akademik e cila shprehet nëpërmjet shkallës së |

| | |
|---|---|
| mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. | kualifikimit të tij si dhe në kapacitetin e tij të mësimdhënies.<br>Bashkëveprimi i stafit akademik, pjesë përbërëse e tre departamenteve të FAS, është një domosdoshmëri në ofrimin e programeve të këtij Fakuleti, një domosdoshmëri që lind nga natyra e programeve që ofrohen në të.<br>Në disa prej takimve të realiazuar në Institucioin, GVJ ju komunikua fakti se kjo lidhje midis programeve është e pashmangshme. Një vepër artistike që të vihet në skenë, ka nevojë për regji, për aktorë, për skenografi dhe kostume, si dhe për kolonë zanore. Kjo është veçantia që bën të mundur koordinimin dhe bashkëvepimin e njësive bazë të këtij Fakulteti. Personeli akademik mbështetet në mobilitet, me qëllim përftimin e eksperiencave dhe metodologjive të reja të mësimdhënies. GVJ ju tha se së fundmi një pjesë e stafit të këtij fakulteti ka qënë për një vizitë mësimore në Sevilla, Spanjë.<br>*(Takime në institucion)* |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se duke patur në qëndër studentin, Institucioni garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, duke siguruar arritjen e rezultateve.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.2**<br>**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në në Rregulloren e programit të | Gjatë takimit të GVJ, Dekani i FAS njoftoi se personeli akademik është përgjegjës për zhvillimin e procesit mësimor dhe realizimin e kontrollit të dijeve për lëndët individuale, grupet mësimore të studentëve që i përcaktohen në çdo fillim viti akademik nga titullari i lëndës.<br>Nga këqyrja e evidencave dhe materialeve të vëna në |

| | |
|---|---|
| studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | dispozicion nga FAS, për këtë program studimi, GVJ vëren se nw këtë program studimi, për të vlerësuar njohuritë e studentit përdoret sistemi shqiptar i vlerësimit me 10 nota (nga 1 tek 10, ku 10 është vlerësimi maksimal). Me këtë sistem bëhet vlerësimi në të gjitha format e kontrollit të përdorura. Notat nga 5 (pesë) e lartë janë kaluese. Kjo formë vlerësimi ishte si element në të gjitha syllabuset e lëndëve.<br>Ashtu siç është e shprehur edhe në RVB, referur Rregullores së ciklit të dytë të studimeve të UART, Rregullores së FAS por edhe Rregullores së programit të studimit, konstatohet së format organizimit të provimit në FAS janë:<br>✓ Provimi i lëndëve speciale<br>✓ Provimi me shkrim në klasë brenda një afati kohor të caktuar;<br>✓ Provim me shkrim e me gojë, ku provimi me shkrim është parakusht për të hyrë me gojë.<br>✓ Provimi në grup në realizimin e veprave artistike sipas programit të miratuar.<br>*(Evidencë 2.3..Rregullorja FAS)*<br>*(Evidencës 2.5 Rregullorja e Programit të Studimit Master)* |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Metodologjia e testimit dhe e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet për secilën lëndë. Studentët njihen me to nga titullari i lëndës, që në orën e parë të mësimit. GVJ konstatoi se këta elementë janë të parashikuar në syllabuset e lëndëve të cilët janë hartuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Elementë mbi strukturën e programit, një përshkrim i shkurtër i secilës lëndë, kalendari akademik, orari i mësimeve, guida e studentit etj. gjenden dhe në faqen web të institucionit www.uart.edu/al<br>*(Evidencë Programet e Lëndëve)* |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të | GVJ për përgjigjen e këtij kriteri i është referuar Rregullores së programit të studimit MA në Aktrim dhe Mësuesi, *neni 13*. Sipas kësaj Rregulloreje, Procesi mësimor me studentët përfshin një larmi formash të mësimit dhe të kontollit të dijeve, të cilat janë:<br>➢ Format e mësimit teorik e praktik: mësimet artistike, |

| | |
|---|---|
| demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | profesionale individuale dhe kolektive, leksionet, seminaret, ushtrimet, praktikat mësimore, projektet artistike individuale dhe kolektive, konsultimet etj.<br>➢ Format e kontrollit të dijeve: bashkëbisedimet, kontrollet teknike, mbrojtje e detyrave e projekteve individuale dhe të kursit, mbrojtje e praktikave profesionale, provime të ndërmjetme, provimet e kursit, provimet e formimit, mbrojtje e temave e diplomave, aktivitetet artistike etj.<br>Po sipas *nenit 13* të Rregullores, Kontrolli i dijeve i studentëve bëhet nëpërmjet:<br>➢*Provimi me shkrim.*<br>➢*Provimi me gojë.*<br>➢*Vlerësimi të detyrave dhe projekteve.*<br>➢*Kombinimi i tre formave të sipërme: me shkrim, me gojë dhe me projekt.*<br>➢*Provimi i formimit artistik (lëndë të formimit special) konsiston në realizimin artistik profesional të një roli apo interpretimi i një personazhi në një shfaqjeje.*<br>➢*Provimi në grup dhe individual.*<br>*Takime në institucion;*<br>*RRegullorja e programit tëstudimit MA në "Aktrim dhe Mësuesi"* |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton së Institucioni ka hartuar një bazë të mirë rregullative si dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, artistike-shkencore duke garantuar zbatimin e tyre.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.3** |
|---|

| **Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Bazuar në syllabuset e lëndëve, GVJ konstatoi se vlerësimi i studentit është përcaktuar si më poshtë:<br>- Pjesëmarrje aktive në orën e mësimit: 10%<br>- Puna e pavarur krijuese: 20%<br>- Detyrat e kursit: 20%<br>- Projektet e kursit: 20%<br>- Provimi përfundimtar: 30%<br>Dekani i FAS i komunikoi GVJ se provimet në FAS, zhvillohen brenda periudhave të përcaktuara në strukturën mësimore të vitit Akademik. Datat e tyre propozohen nga Njësia Bazë, miratohen nga Dekani dhe shpallen jo më vonë se dy javë para fillimit të sezonit. Gjatë takimit me studentet u konstatua se është kusht që para se studenti të hyjë në provime duhet të shlyejë të gjitha detyrimet që ka me lëndën. Nuk është e lejuar shlyerja e detyrimeve midis sezoneve.<br>Provimet në FAS, zhvillohen në tri sezone:<br>a. sezoni i provimeve të dimrit; i cilli zhvillohet mbas përfundimit të semestrit të parë;<br>b. sezoni i provimeve të verës i cili zhvillohet pas përfundimit të semestrit të dytë;<br>c. sezoni i provimeve të vjeshtës i cili zhvillohet përpara fillimit të vitit akademik pasardhës;<br>*(Evidencë 2.4...Rregullore Departamentit të Aktrim dhe Teori)*<br>*(Evidencë 2.5 Rregullorja e Programit të Studimit Master)*<br>*(Evidencë 3.1.Plani mësimor i Programit të Studimit Master)* |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | Për vetë natyrën specifike që kanë programet e studimit të cilat ofrohen në Universitetin e Arteve dhe mënyrës së organizimit të testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, në FAS/UART zbatohet sistemi i provime të cilat zhvillohen në auditor.<br>Aktualisht për programin e studimit Master i Arteve në "Aktrim |

| | |
|---|---|
| | dhe Mësuesi" nuk është vënë në zbatim ndonjë sistem elektronik i testimit të vlerësimit.<br>Gjatë kohës së pandemisë, UART mori masa për organizimin e mësimit dhe kontrolleve online, një eksperiencë e re kjo në zhvillimin e procesit të mësimdhënies nga stafi akademik. Gjatë kësaj kohe filloi të funksionojë sistemi Microsoft Teams i realizuar përmes përdorimit të mjeteve të komunikimit dhe të bashkëpunimit të përfshira në paketën softuer të bazuar në cloud "Microsoft Office 365" (ëëë.office.com/teams.microsoft.com), të zbatuar dhe të administruar nga Sektori i Teknologjisë dhe Informacionit. Për vetë natyrën specifike të ofrimit të programeve të studimit në UART, GVJ Ju komunikua se në fillim Institucioni ishte skeptik se si do të zbatohej ky sistem, por, përgjegjshmëria e stafit akademik dhe e studentëve ishte mjaft premtuese, duke sjellë edhe rezultatet pozitive.<br><br>*(Evidenca 4.9 Manuali i Programit Online Teams)*<br>*(Evidenca 6.17* Manuali i mësimdhënies) |
| **Kriteri 3.** Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. | Vlerësimi përfundimtar i lëndëve bëhët në përputhje me syllabusin e lëndës si dhe mbështetur në Rregulloren mësimore të ciklit të dytë të programeve të studimit dhe në Rregulloren e programit të studimit Master i Arteve në Aktrim dhe Mësuesi duke përdorur fletë provimi vjetor, vlerësimin e praktikës mësimore si dhe vlerësimin e praktikës lëndore. Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore, GVJ pati mundësinë të shikonte disa fletë provimi testimi të njohurive të studentëve.<br>Në Rregulloren e Programit të Studimit Master i Arteve në "Aktrim dhe Mësuesi", ka të përcaktuar qartësisht sa më poshtë:<br>- mënyrën e të provuarit të dijes/sistemin e vlerësimit; *neni 18*<br>- format e mësimit dhe forma e kontrollit; *neni 13*<br>- sezonet e provimeve; *neni 20*<br>- provimi dhe kontrolli i dijes; *neni 21*<br>- dokumentimi i vlerësimit të studentëve; *neni 22*<br>- kushtet e kalimit në vitin pasardhës; *neni 23*<br>- përmirësimi i notës, *neni 24* |

| | |
|---|---|
| | *Evidencë: Rregullorja e programit MA në Aktrim dhe Mësuesi* |
| **Kriteri 4.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Referuar RVB dhe takimeve në institucion, GVJ konstatoi se testimi i njohurive, dijeve me shkrim zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore. Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit, e cila firmoset nga pedagogu që ka hartuar tezën dhe në formatin përmbledhës të vlerësimit të studentëve. Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet konform rregullores së programit të studimit. Gjithashtu, sigurohet infrastruktura e nevojshme e monitoruar me personel akademik dhe administrativ. *(Takime në institucion).* |
| **Kriteri 5.** Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | Programi i Studimit Master i Arteve në "Aktrim dhe Mësuesi", nuk ofron mundësi plagjiature në provim, pasi me studentin pedagogu punon ngushtësisht dhe e di fare mirë mbarëvajtjen e tij të punës dhe të të nxënit përgjatë gjithë vitit akademik.<br>Referuar në RVB dhe takimit me personelin akademik të programit, GVJ ju komunika se Verifikimi i cilësisë së punimeve artistike - shkencore është realizuar përmes platformës anti-plagjiaturë të vënë në dispozicion nga RASH dhe të administruar nga Sektori i TI sipas udhëzimeve të Këshillit të Etikës së institucionit. *(Takime në institucion; RVB*). |
| **Kriteri 6.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Gjatë takimit në Sekretarinë mësimore por edhe gjatë takimeve me studentët dhe Drejtuesit e FAS, GVJ ju komunikua se në Universitetin e Arteve, nga data 30 shtator 2021, përdoret sistemi PITAGORA për menaxhimin e studimeve dhe të kurrikulës në shërbim të marrëdhënies Pedagog - Student – Institucion. Ky sistem është mundësuar nga Rrjeti Akademik Shqiptar (RASH) dhe administrohet nga Sektori i TI në bashkëpunim me RASH, si edhe në koordinim me Sekretaritë Mësimore në Fakultete dhe strukturat përkatëse në Rektorat. Sistemi përdoret nga pedagogët për pasqyrimin e rezultateve dhe përpilimin e procesverbaleve, përdoret nga studentët për informimin e tyre lidhur me aktivitetin akademik në Universitet (kalendarët, provimet, notat, njoftimet, etj.), si dhe përdoret nga personeli administrativ në Rektorat për përpunim të dhënash statistikore. |

| | |
|---|---|
| | *(Evidencë 2.4..Rregullore Departamentit Aktrim dhe Teori)*<br>*(Evidencë 2.5 Rregullorja e Programit të Studimit Master)*<br>*(Evidencë 4.11. Screenshote nga sistemi Pitagora)* |
| **Kriteri 7.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | GVJ ju komunikua si nga studentët ashtu edhe nga stafi akademik se studenti merr vlerësimin për provimin e kryer brenda tre ditëve nga data e dhënies së provimit. Studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi nga ana e tij, ose të kontestojë rezultatin e marrë. Komisioni i vlerësimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara apo regjistrimet (kur ka) të studentit me tezën e zgjidhur. Në rast se studenti dëshiron të përmirësojë notën, ai e ka këtë të drejtë. Në Rregulloren e programit të studimit, *neni 24* është përcaktuar qartësisht si realizohet përmirësimi i notës.<br>*(Evidencë Rregullore e Programit të studimit)* |
| **Kriteri 8.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet. | Në Rregulloren Mësimore përcaktohet se Studenti ka të drejtë të ankohet. Ankesa duhet të depozitohet me shkrim brenda një afati prej 24 orësh nga shpallja e rezultatit në Dekanat. Ankesa bëhet në rast se studenti konsideron se ndaj tij janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimit ose është bërë vlerësim i pameritur për përgjigjen që ka dhënë, ose për performancën artistike që ka realizuar. Kjo ankesë shqyrtohet nga Dekani, i cili mund të thërrasë për sqarime komisionin e provimit dhe vetë studentin dhe pas gjykimit të çështjes, merr vendimin përkatës të formës së prerë brenda 3 (tre) ditëve. Vendimi i Dekanit përcakton në se kërkesa e studentit është e drejtë ose jo. Kur ankesa është e drejtë, Dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit për të cilin studenti është ankuar dhe vendos që studenti të japë përsëri provimin, me të njëjtin komision ose me një komision të ri dhe nën monitorimin e një përfaqësuesi të caktuar nga Dekani, në një datë tjetër brenda sezonit ose jashtë tij, por jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i sezonit përkatës të provimeve. *(Ev. Rregullore e Programit të studimit)* |
| **Konkluzione** | *GVJ siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.4**<br><br>**Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve. | GVJ konstaton nga këqyrja e DVV por edhe qartësimit gjatë komunikimit në Institucion, se programi synon një edukim profesional, bashkëkohor jo vetëm në fushën e Aktrimit, por gjithashtu ofron një përgatitje tërësore, profesionale në fushën e mësuesisë. Programi ofrohet në dy vite akademike me 120 kredite. Ky program synon:<br>- të ofrojë një formim teorik e praktik rreth çështjeve të fushës së artit dhe të mësimdhënies për të krijuar një formim të plotë profesional dhe psiko-pedagogjik;<br>- të formojë kompetenca për të përmbushur efektivisht rolin e mësuesit të lëndës së artit;<br>- të zhvillojë aftësi të kërkimit shkencor në fushën e specialitetit;<br>- të zhvillojë aftësitë e duhura për organizimin praktik të veprimtarive artistike kulturore (kolektive dhe individuale) që zhvillohen në të gjitha ciklet e arsimit parauniversitar;<br>Referuar Rregullores së programit të studimit, *neni 39*, pas përfundimit të studimeve në këtë program studimi, studenti ka përvetësuar:<br><br>- Njohuri dhe aftësi, të përgjithshme dhe speciale, të fituara gjatë programit të studimit:<br><br>- Njohuri mbi modelet estetike të domosdoshme për vizionin skenik të personazhit të tekstit dramatik, rolit në shfaqje<br><br>- Njohuri mbi personazhin/personazhet duke pasur parasysh strukturën e vënies në skenë të shfaqjes në tërësi, si dhe njohuri për elementët individualë të kësaj strukture. |

| | |
|---|---|
| | - Njohuri dhe shprehi të thelluar në punë me regjisorin dhe aktorët, aftësi të mira për të interpretuar.<br>- Njohuri dhe shkathtësi interpretuese sipas idesë dhe temës së shfaqjes.<br>- Njohuri të thelluara të historisë së teatrit, si dhe aftësi për të bërë analiza dhe krahasime në lidhje me zhvillimin e historisë së teatrit.<br>- Njohuri mbi sistemet, zhanret dhe stilet artistike krijuese, skenike-teatrore.<br>- Njohuri mbi dramaturgjinë, menaxhimin letrar dhe shkrimin e dramës.<br>- Njohuri të mira mbi filozofinë e artit<br>- Njohuri mbi analizën e dramës dhe spektaklit, si dhe mbi kulturën e kritikës teatrale.<br>- Njohuri në fushën e pedagogjisë së përgjithshme, etj<br>*(Evidëncë Rregullorja e Porogramit të studimit)* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). | GVJ ju komunikua se vetë specifika e programit dhe forma e kontrollit të dijeve përballë publikut (provimi, shfaqja) u krijon studentëve të këtij programi studimi aftësitë dhe shprehitë e komunikimit si dhe nxit te ata procesin e të menduarit dhe shqetësimin jo më si një individ i veçuar por, si një qenie me përgjegjësi të theksuar shoqërore. Një nga kriteret e pranimit të studentëve në Programin e "Aktrim dhe Mësuesi" është edhe zotërimi i një gjuhe të huaj (një nga pesë gjuhët kryesore evropiane). Kjo është domosdoshmëri edhe në drejtim të shkëmbimeve apo edhe të mobilitetit të studentëve. |
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton | Departamenti organizon takime me stafin e angazhuar në programin e studimit në të cilat diskutohen çështje që kanë të bëjnë me përmirësimin e programit, literaturës, aspekte teknike të mësimdhënies, rritjen e cilësisë së organizimit të orës së mësimit, kërkimin artistiko - shkencor dhe angazhimin e studentëve në projekte detyra kursi për të përthithur sa më mirë aftësitë dhe kompetencat që duhet të marrin nga secila lëndë.<br>Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde janë objekt i |

| | |
|---|---|
| studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse. | diskutimeve dhe vlerësimeve nga vetë pedagogët për lëndët që mbulojnë, nga studentët (nëpërmjet pyetsorit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies) si dhe nga Përgjegjësi i Departamentit. |
| **Kriteri 4.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | Procesi i arsimimit dhe vetë natyra e punës në FAS/Aktrim determinon një ndër elementët e rëndësishëm dhe specifik të procesit mësimor në këtë program studimi, siç është puna në grupe të ndryshme ndërmjet studentëve.<br>Studentët domosdoshmërisht bashkëveprojnë me njëri-tjetrin jo vetëm me studentët e këtij programi por edhe me studentët e programeve apo departamenteve të tjera, brenda institucionit apo dhe në institucione të tjera artistike kulturore.<br>Nëpërmjet punës në grup si një nga veçoritë e këtij programi, veç të tjerash synohet të zhvillohen aftësi intelektuale të tilla, si: arsyetimi profesional, zgjidhja e problemeve dhe mbajtja e qëndrimeve artistike; aftësi interpersonale si: të dëgjuarit, të folurit, bashkëbisedimi, bashkëveprimi, përgjejgësia sociale.<br>Gjatë zhvillimit të procesit mësimor, pedagogët krijojnë klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative e artistike shkencore të studentëve. Stafi akademik inkurajon studentët të zhvillojnë ide, projekte artistike sipas specifikave të tyre dhe t'i bëjnë të zbatueshme ato në fushat përkatëse. FAS/UART mbështet idetë inovative në art të studentëve, jep informacione bashkëkohore në fushën e artit dhe kulturës nëpërmjet aktrimit e veprimtarive të ndryshme artistike si dhe duke rritur bashkëpunimin dhe mobilitetin e studentëve me institucione të tjera të arsimit të lartë.<br>*(Evidencë 2.4..Rregullore Departamentit)*<br>*(Evidencë 2.5 Rregullorja e Programit të Studimit Master)* |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit. | GVJ-së, ju tha gjatë takimeve se personeli akademik efektiv dhe me kontratë në FAS organizon në mënyrë të vazhdueshme, shfaqje premiera, mbrëmje poetike, biseda, shkembime, në bashkëpunim me trupa apo teatro vendas apo të huaj duke sjellë një larmi programesh, formash, gjinish, stili dhe epoka të ndryshme. Kjo veprimtari artistike e cila zhvillohet jashtë strukturës së programit të studimit, e pasur në formë dhe përmbajtje, shërben për studentët në veçanti por edhe për të gjithë artistët e tjerë si forma më efikase për të prezantuar |

| | |
|---|---|
| | zhvillimet dhe arritjet më të reja në fushën e Aktrimit, regjisurës dhe atë të artit në përgjithësi. |
| **Kriteri 6.** Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato. | Nga shqyrtimi i DVV dhe takimet në institucion, GVJ konstatoi se theksi i bashkëpunimeve vendoset kryesisht te kërkimi artistik dhe gjetja e formave dhe metodave të reja shprehëse për të transmetuar, publikuar idetë dhe mesazhet që shqetësojnë aktorin, regjisorin dhe njëherazi edhe shoqërinë.<br>Studentët nxiten të marrin pjesë në veprimtari krijuese artistike si shfaqje, variete, koncerte të fjalës poetike të organizuara nga vetë ata. Kjo është pjesë e veprimtarive të integruara dhe integruese të Aktrimit për një mësimdhënie gjithëpërfshirëse dhe bashkëpunim krijues. Çdo shfaqje e realizuar është një proces krijues më vete, me një punë "laboratorike" që fillon gjithmonë nga e para, pra kërkimi për shfaqjen, rolin, figurën artistike është një proces që nuk resht.<br>AKTRIMI/FAS krijon gjithë mundësitë me salla, atelie, studio, studio provash, klasa provash në tavolinë, bazë materiale për realizimin e dekoreve, garderobë dhe rekuizitë, personel ndihmës akademik, pajisje ndriçimi dhe audio, kompjuterë dhe teknikë për përpunimin digjital të efekte zanore në shërbim të realizmit të projekteve.<br>*(Evidenvë RVB; Takime dhe vizitë në hapësirat e institucionit).* |
| **Konkluzione** | *GVJ vëren se Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synon zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.5**<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton procedurë të posaçme për | Detyrimet përmbyllëse të studentëve janë shprehur qartë në Rregulloren e Programit të Studimit Master i Arteve në Aktrim |

| | |
|---|---|
| detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike. | dhe Mësuesi, dhe të bëra publike në faqen web-t UART. Disa prej detyrimeve janë:<br>✓ Të ketë plotësuar kriteret detyruese të vendosura për atë lëndë të parashikuara në planin mësimor;<br>✓ Të ketë plotësuar kushtet që lidhen me frekuentimin e formave mësimore;<br>✓ Të ketë mbrojtur detyrimet për praktikat mësimore, punët laboratorike, nëse lënda parashikon forma të tilla, brenda afatit të parashikuar në grafikun e detyrimeve, para fillimit të sezonit të provimeve;<br>✓ Të jetë regjistruar në sekretarinë mësimore për dhënie provimi në sesionin dhe datën përkatëse;<br>Procedurat e diplomimit si dhe kriteret e hyrjes në diplomim janë të përcaktuara në Rregulloren e studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë Master, si dhe në Rregulloren e programit të studimit |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse. | GVJ u vu në njohuri se UART, si strukturë e informimit dhe të këshillimit të studentëve përveç sekretarive mësimore të fakulteteve është edhe zyra e Sektorit Mësimor dhe Informimit të Studentëve. Me këtë Sektor, GVJ pati një takim, nga i cili u informua për punën e tij të madhe duke pasur si çështje primare këshillimin dhe informimin e studentëve. Këshillimi realizohet nëpërmjet formave të ndryshme, si për shembull këshillimin dhe informimin online nëpërmjet faqes zyrtare të UART.<br>Gjithashtu edhe Pedagogët e lëndëve mbështesin informimin e studentëve nëpërmjet kontakteve të herëpashershme dhe të vazhdueshme me ta duke i udhëzuar lidhur me detyrimet përmbyllëse dhe kryesisht duke i udhëzuar edhe me provimin e diplomimit të tyre. GVJ Ju komunikua se studenti nuk mund të mbrojë temën e diplomës pa marrë miratimin e udhëheqësit si garantues i cilësisë së saj akademike. Në çdo rast, studenti nuk mund të mbrojë punimin e diplomës pa shlyer të gjitha detyrimet e tjera të programit të studimit. Me qëllim informimin e studentëve, Universiteti i Arteve disponon mjete të komunikimit të jashtëm siç është Faqja elektronike e FAS. |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e | Punimi i diplomës është një punë e pavarur dhe krijuese e studentit në formën e një programi artistik në fushën e |

| | |
|---|---|
| provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | Programit të Studimit Aktrim dhe Mësuesi. Sipas RVB, përgatitja dhe paraqitja e punimit/programit të diplomës në FAS bëhet sipas normave të përcaktuara nga "Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e FAS" dhe ndjek procedurat e miratuara nga Dekani përpara se ajo të mbrohet në komisionin përkatës. Punimi i diplomës përmban një sërë detyrash e kërkesash, mënyra e shtrimit të të cilave i jep mundësi studentit, që nëpërmjet njohurive të fituara gjatë periudhës së shkollimit dhe punës konkrete projektuese artistike, të tregojë aftësitë e tij profesionale artistike dhe kompetencën për të kryer realizime artistike në fushën përkatëse. |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | Sipas RVB, i gjithë semestri i dytë i vitit të dytë të studimit Master, i kushtohet përgatitjes së diplomës nga student dhe ky process realizohet në bashkëpunim me pedagogun përkatës.<br>Udhëheqësi i temës së diplomës, i cili në këtë program studimi është pedagogu i lëndës speciale, në bashkëpunim me studentin, përcakton programin e diplomës.<br>Sipas Rregullores se programit të studimit, studenti duhet të respektojë afatet për të bërë të mundur realizimin me sukses të programit për mbrojtjen e diplomës në sezonin e caktuar të tij. Nëse studenti, për arsye të ndryshme objektive dhe subjektive nuk arrin të mbrojë diplomën në sezonin e caktuar, ai ka të drejtë të mbrojë diplomën në tre sezonet pasardhëse.<br><br>*(Evidencë 2.3.Rregullorja FAS, neni 45)*<br>*(Evidencë 2.4.Rregullore e Departamentit Aktrim)* |
| **Kriteri 5.** Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | Nuk mund të aplikohet për këtë program, pasi natyra e këtij programi është krejtësisht artistike. |
| **Kriteri 6.** Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes | Sipas RVB por edhe sipas bisedave të zhvilluara në Institucion, në përfundim të procesit të provimit të diplomës, Kryetari i Komisionit, mbledh anëtarët e komisionit për vlerësimin e |

| | |
|---|---|
| së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë. | punimit të diplomantit. Çdo anëtar i komisionit bën vlerësimin me pikë për çdo diplomant duke e nënshkruar atë. Pasi bëhet mesatarizimi i vlerësimit që ka dhënë çdo anëtar i komisionit dhe në prani të tyre, komisioni i komunikon çdo diplomanti notën me të cilën është vlerësuar. Vlerësimi i anëtarëve të komisionit dokumentohet dhe i bashkëngjitet proces-verbalit të mbrojtjes së diplomave, në të cilin regjistrohet nota përfundimtare. Në rast se studenti vlerësohet me notë negative në mbrojtjen e diplomës ose nuk paraqitet për mbrojtjen e diplomës në sezonin e parë pas përfundimit të studimeve, ai mund të mbrojë punim e diplomës, në tre sezonet pasardhëse. |
| **Kriteri 7.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Mbështetur në takimet në Institucion, në përfundim të studimeve, studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor dhe ka mbrojtur diplomën, pajiset me diplomën përkatëse, të shoqëruar me suplementin e diplomës.<br><br>Diploma plotësohet në zbatim me Udhëzimin nr. 25, datë 10.11.2017 "Për regjistrimin e formave të diplomave dhe certifikatave në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor". |
| **Kriteri 8.** Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. | Programet mësimore, forma e tyre, planet mësimore, shoqëruar me kreditet e detyrueshme të studimeve, hartohen në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe ruhen dhe menaxhohen sipas njësive dhe strukturave të përcaktuara në Statutin dhe Rregulloret e UART.<br><br>Ruajtja e dokumentacionit në letër (hardcopy) kryhet nga Arkiv-protokoll i UART, e cila është përgjegjëse për të gjithë dokumentacionin e Institucionit si dhe për korrespondencën shkresore institucionale dhe ndër institucionale.<br><br>Përveç Arkivës-Protokollit qendrore të UART, FAS ka arkivën e tij për komunikimet shkresore zyrtare me vulën dhe protokollin përkatës. Materialet e Sekretarisë Mësimore të FAS, e cila është njësia kataloguese dhe arkivuese e informacionit për këtë Fakultet, arkivohen nga vetë Fakulteti deri në 3 vjet.<br><br>*(Evidencë 4.15.Pasqyrë për përdorimin e pajisjeve dhe* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *shërbimeve të teknologjisë"* | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm..* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes sëstandardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.6**<br>**Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përftimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale. | Universiteti i Arteve ka mjedise të mjaftueshme të llojit salla, studio, atelier, lektoriume me kapacitete të konsiderueshme. Përveç kësaj, UART-i ka marrëveshje bashkëpunimi në fusha të ndryshme, me interes të ndërsjelltë të palëve, me shumë institucione dhe institute të fushave të ngjashme me ato që mbulon UART-i. |
| **Kriteri 2.** Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale. | **Nuk aplikohet për këtë program** |
| **Kriteri 3.** Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë | **Nuk aplikohet për këtë program** |

| | |
|---|---|
| studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës. | |
| **Konkluzione** | *GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi IV.1**<br>**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e | Bazuar në RVB *(tab 6.1, 6.2 dhe 6.3)* dhe vizitës në institucion, për tre vitet e fundit akademike (2019-2020, 2020-2021 dhe 2021-2022), konstatohet që, personeli akademik i angazhuar në zhvillimin e këtij program studimi, respekton kriteret ligjore në fuqi, si dhe ofron ekspertizën e nevojshme lidhur me mbarëvajtjen cilësore të procesit të mësimdhënies, sa më sipër:<br>- Për vitin akademik **2019-2020,** janë angazhuar 16 personel akademik, nga të cilët 15 personel akademik efektiv (4 Prof., |

| | |
|---|---|
| programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij. | 4 Prof.Asoc, 6 Doktor dhe 1 MA) dhe 1 personel efektiv me kontratë me dradën Doktor;<br>- Për vitin akademik **2020-2021**, janë angazhuar 16 personel akademik, nga të cilët 13 personel akademik efektiv (2 Prof., 4 Prof.Asoc, 6 Doktor dhe 1 MA) dhe 3 personel efektiv me kontratë (1 Prof., 1 Doktor dhe 1 MA);<br>- Për vitin akademik **2021-2022**, janë angazhuar 18 personel akademik, nga të cilët 13 personel akademik efektiv (3 Prof., 4 Prof.Asoc, 5 Doktor dhe 1 MA) dhe 5 personel efektiv me kontratë (1 Prof., 2 Doktor dhe 2 MA);<br><br>Bazuar në të dhënat e mësipërme evidentohet plotësimi i kuadrit ligjor lidhur me ekspertizën dhe nivelin profesional në procesin mësimdhënës në një program të ciklit të dytë, Bazuar në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", pika 3/c Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për çdo program studimi", rezulton se raporti PAK dhe PAE, për vitin akademik 2021-2022, është 13-5 (72%-28%).<br><br>*Evidence RVB Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Arteve Aktrim dhe Mësuesi. Tabela 6.1, 6.2, 6.3.* |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. | Konstatuam se, personeli akademik me kohë të plotë, pranë Departamentit Aktrim dhe Teori, mbulon ngarkesën dhe zhvillon aktivitetin mësimdënes, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe konform Udhëzimit nr. 29, dt. 10.09.2018, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë".<br><br>*Evidenca 5.2 Pasqyrat e ngarkesave Mësimore të angazhimit vjetor të Stafit Akademik FAS 2021 -2022.* |
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e | Bazuar në takimin me Drejtorinë e burimeve njerëzore konstatuam se, institucioni derdh rregullisht kontributet shoqërore dhe shëndetësore të stafit akademik dhe të studentëve që zhvillojnë praktikat mësimore pranë shkollave përkatëse. |

| | |
|---|---|
| studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. | Gjithashtu, në takimin me personelin akademik, të programit të studimit, evidentohet qëndrueshmëri kontraktuale, si dhe korrektësi në pagesat e kryera, bazuar në legjislacionin në fuqi.<br>*Evidenca 3.3.9 Sigurimet shoqerore per studentet qe zhvillojne praktikat mesimore.* |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Konstatuam se, vlerësimi për përzgjedhjen e personelit realizohet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, bazuar në propozimin e departamentit, e cila përditëson në mënyrë të vazhdueshme të dhëna që lidhen me aktivitetin kërkimor të stafit akademik, CV e tyre akademike, kontratat, formularët e parashikimit dhe realizimit të ngarkesës mësimore.<br>*Evidenca 3.11 Të dhëna mbi titujt akademikë dhe gradave shkencore të stafit akademik të programit të studimit dhe CV të personelit akademik të angazhuar në këtë program.*<br>Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore administron ruajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit të personelit akademik të DAT. Bazuar në kuadrin ligjor ajo arkivon dosjet përkatëse për çdo anëtar të PAE dhe PAK, si dhe marrëveshjet kontraktuale të nënshkruara me stafin akademik në përfundim të gjithë procesit të rekrutimit.<br>*Evidenca 5.9 Marrëveshjet e Personelit Akademik 2019-2020.*<br>*Evidenca 5.5 Kontratat e punës së stafit akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme.pdf* |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | Konstatuam se, Fakultetiti i Artit Skenik ka punonjës ndihmës për realizimin e këtij program studimi në përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve teknologjike mësimore si dhe në realizmin e aktiviteteve artistike dhe mësimore, për vehtë natyrën specifike të këtij program studimi, si:<br>- Krye Sekretare<br>- Sekretare e Kurikulës dhe Mardhënie me Studentët<br>- Laborant i Skenografisë<br>- Specialist i Regji Filmi dhe TV<br>- Laborant i Garderobës dhe Rekuzitës<br>- Laborant dekori<br>- Punonjëse Pastrimi |

| | |
|---|---|
| | *Evidenca 5.8 Listë e stafit ndihmës akademik në FAS.* |
| **Kriteri 6.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ. | Nga shqyrtimi i RVB dhe takimet fizike, konstatuam se, institucioni mbledh dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit akademik sipas organigramës së UART, në lidhje me strukturën analitike të FAS, në rang njësie dhe personelin përkatës. Departamenti, mbledh, ruan dhe përditëson angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik të përfshirë në program dhe personat përgjegjës për organizimin e programit të studimit.<br>*Evidenca 1.15.1 VSA Nr. 12 dt. 07.07.2021 ""Për miratimin e Statutit të UART".*<br>*Evidenca 2.17.1 - Organigrama-2021-uart.*<br>*Evidenca 2.8.4 Tabelat e stafit akademik FAS 2020-2021.* |
| **Kriteri 7.** Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | Institucioni "UART" ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me kompani dhe ZVA dhe shkolla të arsimit parauniversitar në të gjithë vendin. Kryesisht, departamenti ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me ZVA Tirane, ku shihet se janë të përcaktuara qartë detyrat e secilit aktor. UART merr përsipër: deklarimin e studentëve praktikantë lidhur me sigurimet shëndëtësore, sigurimin e pedagogut mentor, ndihmën e nevojshme për studentët praktikantë, ndjekjen e punës së studentëve dhe vlerësimin e studentëve për paketën e praktikës.<br>ZVA Tiranë, merr përsipër, mundësimin e zhvillimit të praktikave për studentët, sipas shkollave dhe nivelit të tyre të studimit, si dhe në dhënien e mendimeve për vlerësimin e studentëve praktikantë.<br>*Evidenca 3.3.1 Marrëveshje Bashkëpunimi për Zhvillimin e Praktikës Mësimore për Studentët e UART.*<br>*Evidenca 3.3.2 Formular Shoqërues për ushtrimin e Praktikës Mësimore.*<br>*Evidenca 3.3.8 Mbi zhvillimin e praktikave të studentëve në ZVA të ndryshme.* |

| | |
|---|---|
| **Kriter 8.** Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. | Realizimi i praktikave mësimore, zhvillohet sipas një protokolli të mirëpërcaktuar lidhur me rolin e institucionit dërgues dhe institucionit pritës. Formularët dhe dosja e praktikës janë pjesë përbërëse e vlerësimit final të studentit, si dhe paraqesin në mënyrë të qartë veprimtaritë, orët, mënyrat dhe modelet e aplikuara përgjatë zhvillimit të procesit mësimor.<br>*Evidenca 3.3.2 Formular Shoqërues për ushtrimin e Praktikës Mësimore.*<br>*Evidenca 3.3.3 Skeda e studentit Aktrim dhe Mësuesi.* |
| **Konkluzione** | - *Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, qartësisht të pasqyruara, GVJ, konstaton se, personeli akademik efektiv dhe me kontratë, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit;*<br>- *Konstatuam gjithashtu, se zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore administron ruajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit të personelit akademik të DAT dhe se departamenti, mbledh, ruan dhe përditëson angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik të përfshirë në program;*<br>- *Konstatuam se realizimi i praktikave mësimore, zhvillohet sipas një protokolli të mirëpërcaktuar lidhur me rolin e institucionit dërgues dhe institucionit pritës;*<br>*Përsa me sipër, evidentojmë përputhshmëri të plotë në zbatimin e standardeve dhe kritereve ligjore të përcaktuara.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.2** |
|---|

| Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | Nga vizita e mjediseve të institucionit konstatuam se, për shkak të specificitetit që ky program studimi ka, kurset e këtij program studimi, zhvillohen në kampusin universitar, si dhe infrastruktura e universitetit përmban mjedise me përmasa të mëdha dhe me kushte të mira fizike për zhvillimin e jo vetëm të mësimdhënies, por dhe të veprimtarive artistike dhe kërkimore shkencore. Disa nga mjediset më rëndësishme për zhvillimin e procesit të mësimdhënies, por edhe të veprimtarive artistike dhe kërkimore shkencore janë:<br><br>Salla e perfomancave, Black-Box, me dy mjedise të ndryshme me kapacitet 40 dhe 200 e pajisur me infrastrukturë kompjuterike dhe audio-vizuale. Klasat e filmit, laboratori i filmit, klasa e artit skenik me kushte të përshtatshe fizike dhe teknologjike për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike dhe praktike.<br><br>*Evidenca 5.10 Dosja e infrastrukturës FAS dhe ambjenteve të përbashkëta.* |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | Nga vizita në institucion, konstatuam se, disa nga mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, biblioteka janë të pajisura me mjete e duhura elektronike dhe teknologjike, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, si dhe veprimtaritë artistike përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe të nxënit.<br><br>Institucioni, ka kapacitet infrastrukturor dhe hapësira të plota për akomodimin e studentëve në këtë program studimi, duke përmbushur kështu standardet e duhura për student.<br><br>*Evidenca 5.10 Dosja e infrastrukturës FAS dhe ambjenteve të përbashkëta.* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | Nga vizita e mjediseve, konstatuam se, klasat mësimorë, studiot dhe laboratoret janë të pajisur me mjetet e nevojshme për realizimin e procesit mësimor (banga, karrike, pajisje audiovizive, tabela etj).<br><br>Evidentuam se, FAS ka katër laboratorët mësimorë të pajisur me aparaturat përkatëse që janë të nevojshëm për mbarëvajtjen e procesit mësimor në kuadër të specifikës që ky program studimi ka. Gjithashtu, gjatë vizitës në institucion, konstatuam se mjediset mësimore si zyra, studiot, klasat, laboratorët, sallat e performancës, janë të pajisuara me mjetet e nevojshme fizike, teknike dhe teknologjike, të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të kurseve që ofron ky program studimi për aftësimit teorik, praktik si dhe artistik.<br><br>*Evidenca 5.10 Dosja e infrastrukturës FAS dhe ambjenteve të përbashkëta.*<br><br>*Evidenca 5.11 Lista e pajisjeve në shërbim të RRFTV.* |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | Nga vizita në institucion, konstatuam se nfrastruktura qendrore e shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit në Institucion përbëhet nga 6 pajisje server dhe 3 njësi network storage. Aktualisht, në institucion janë të instaluara mbi 50 pajisje kompjuterike të ndërlidhjes së rrjetit kompjuterik në tërësi, të përbërë nga switch-e, media converter-a, router, firewall, transmetues me valë të brendshme dhe të jashtëm.<br><br>Rezulton se, FAS disponon pesë laboratorë të përpunimit dhe prodhimit filmik të pajisura me infrastrukturë rrjeti kompjuterik fizik dhe valor, si dhe me pajisje kompjuterike workstation / monitore / videoprojektore / infrastrukture audio, etj, si dhe një laborator i departamentit Skenografi-Kostumografi i pajisur me infrastrukturë rrjeti kompjuterik fizik dhe valor, si dhe me pajisje kompjuterike workstation dhe laptop, në shërbim të proceseve akademike.<br><br>Rezulton, gjithashtu, se pranë Bibliotekës së UART ndodhet laboratori i informatikës, i pajisur me softuerët përkatës në mënyrë që të t"i shërbejë sa më mirë programit mësimor me një kapacitet afërsisht 40 vendesh. Ai është në parametra të mirë për |

| | |
|---|---|
| | realizimin e nevojave të programit të studimit në lidhje me përdorimin e teknologjisë në drejtim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Laboratori, rezulton se shërben për zhvillimin e detyrave dhe projekteve të kursit të studentëve, por edhe për aktivitete të ndryshme nga vetë departamenti. Një punonjës i IT-së është në dispozicion të mirëmbajtjes së laboratorit dhe rrjetit kompjuterik të UART, gjatë kohës së zhvillimit të orëve mësimore, si dhe ofron asistencë teknike për studentët dhe stafin akademik. *Evidenca 4.15.1 Infrastruktura IT e UART.* |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatore me kapacitetet e nevojshme. | Konfirmojmë që, institucioni ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me institucione arsimore parauniversitare, për realizimin e praktikave mësimore të studentëve të këtij program studimi. Me mundësitë dhe infrastrukturën që ka, UART, ka kapacitete të mjaftueshme për të organizuar veprimtari praktike dhe artistike si dhe veprimtari të posaçme në bashkëpunim me institucione të tjera kulturore brenda dhe jashtë vendit si dhe institucione homologe jashtë vendit.<br><br>*Evidenca 3.3.1 Marrëveshje Bashkëpunimi për Zhvillimin e Praktikës Mësimore për Studentët e UART.*<br><br>*Evidenca 2.14 Marrëveshje Bashkëpunimi të UART me Institucione homologe brenda dhe jashtë vendit.* |
| **Konkluzione** | *Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë se institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore dhe asaj artistike. Gjithashtu konstatojmë se institucioni, ka kapacitetet e duhura infrastrukturore dhe hapësira të plota për akomodimin e studentëve në këtë program studimi, duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara. Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi IV.3<br><br>Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme). | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | Literatura bazë dhe ndihmëse në shërbim të programit të studimit plotëson të gjitha kriteret e vlefshmërisë dhe përdorimit. Ajo gjendet si fizikisht, ashtu edhe në rrugë elektronike duke garantuar kështu një shfrytëzim të mirë të saj për realizimin e detyrave dhe projekteve të kursit si dhe realizimit e aktiviteteve të ndryshme artistike. Gjatë vizitës në institucion konstatuam se, literatura e për realizimin e këtij program studimi përbëhet nga:<br>- Literatura bazë;<br>- Literatura ndihmëse;<br>- Periodik të huaj;<br>- Periodik shqiptare;<br>- Enciklopedi, diksionerefjalor;<br>- Dorëshkrime të kompozitorëve shqiptare;<br>- Koleksione periodike në fushat e artit;<br>- Punime teorike universitare dhe pasuniversitare të studentëve dhe pedagogëve:<br>- Monografi shkencore të fushave të ndryshe mbi muzikën, letersinë, artin dhe kulturën në gjuhën shqipe.<br><br>*Evidenca 5.15 Lista përfshirëse e titujve fizikë në bibliotekën e UART.* |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit. | Konstatojmë se, njësia kryesore me propozim nga njësia bazë çdo fillim viti akademik paraqet listën e kërkesave të titujve për pasurimin e fondit të titujve në shërbim të realizimit të programeve të studimit që ofron. |

| | |
|---|---|
| | *Evidenca 5.12.3 Biblioteka lista e kërkesave.*<br><br>*Evidenca 3.15 Lista e titujve RRFTV në Bibliotekën UART.* |
| **Kriteri 3.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | Nga vizita në institucion, konstatuam se, biblioteka është e konceptuar në disa mjedise të ndërlidhura së bashku. Përveç mjedis ku është vendosur fondi i librave, gjenden gjithashtu edhe dy salla laboratorë si, Salla e fondit të hapur dhe Media Library të pajisura me inftastrukturë rrjeti kompjuterik. Në ambjentet e bibliotekës ndodhet gjithashtu salla "Multimedia", e cila është e pajisur me 20 kompjutera që kanë akses në internet të pajisur me software specifik në mbështetje të punës individuale studimore.<br><br>Shërbimi eletronik i bibliotekës ofrohet nëpërmjet dy sistemeve:<br><br>• Sistemi i menaxhimit përmes të cilit biblioteka kryen katalogimin dhe shpaqjen përmes shfletuesit publik (OPAC) për audiencën e gjërë dhe.<br>• Sistemi i arkivit digjital ku përdoruesit mund të shfletojnë materialet elektronike.<br><br>*Evidenca 5.14 Lista e burimeve elektronike në të cilat ka akses UART në rrugë digjitale.*<br><br>*Evidenca 5.16 Lista e pajisjeve të Bibliotekës së UART.* |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | Konstatojmë se, Biblioteka eshtë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaj, libra apo revista shkencore të nevojshme, të përshtatshme për mbulimin e kurseve dhe veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës të programit të studimit. Biblioteka e UART luan rolin e një biblioteke speciale për të gjithë fishat e artit në Shqipëri. Bazuar në vizitën në institucion, rezulton se numri i teksteve përfshin libra teorik të artin skenik, regji, skenografi, kostumografi, filmi, koreografi; koleksionin e dramës: drama, përkthime, komedi, periodikë si dhe letërsi shqip dhe huaj dhe shqipe si më poshtë:<br><br>• 45. 000 libra, albume, partitura & parte;<br><br>• 40.000 File (audio/ pdf) – muzike e huaj dhe shqiptare ;<br><br>• 1000 doreshkrime;<br><br>• 897 perkthim dhe adaptim; |

| | |
|---|---|
| | • 400 drama te perkthyera ne shqip<br>• 68 tituj (periodik i huaj);<br>• 42 tituj (periodiku shqiptare);<br>• 20 Titles (gazeta).<br>• Fondi referues – enciklopedi, diksionere, tituj 150 +100 fjalor<br>• Letersia shqipe - 3040 tituj<br>• Letersia e huaj – 2646 tituj<br>• Drama, perkthime teorike, ne shaptilograf, printime - 1000 tituj<br>• Estetika, filozofi, psikologji, sociologji – 200 tituj<br>• Seriale – 1455 tituj<br>• Teoria e Drames, regjise - 700 tituj<br>• Histori teatri - 308 tituj<br>• Filmi – 460 tituj<br>• Teatri – 409 tituj<br>• Koreografi - 300 tituj<br>Një vend të rëndësishëm në fondin e saj zënë fondet speciale si<br>• 1000 dorëshkrime të kompozitorëve shqiptare.<br>• 3000 koleksione periodike në fushat e artit.<br>• 1500 punime teorike universitare dhe pasuniversitare<br>• 1400 fotokopje të parteve dhe partiturave të formacioneve orkestrale.<br>• 750 tituj monografi shkencore të fushave të ndryshe mbi muzikën, letersinë, artin dhe kulturën në gjuhën shqipe.<br>***Rekomandohet shtimi i fondit të teksteve fizik dhe elektronik në fushën e edukimit (literature bazë dhe e këshillueshme) për plotësimin e nevojave të studenteve në realizimin e leksioneve, detyrave dhe projekteve të kurseve me karakter psiko-pedagogjik që ky program studimi ofron për formumin e mësuesve të ardhshëm.*** |

| | |
|---|---|
| | *Evidenca 5.17 Rregullorja e funksionimit të bibliotekës UART.pdf*<br><br>*Evidenca 5.12.1 Listat e literaturës RRFTV në Bibliotekën Shkencore të UART.* |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit. | Nga vizita në institucion, konstatuam se, menaxhimi i librave të bibliotekës është i realizuar nëpërmjet skedarëve dhe gjithashtu nëpërmjet platformës online për të krijuar kushte për akses të shpejtë, të barabartë e pa pagesë për studentët.<br><br>Rezulton se, periodiku retrospektive - kërkimi bëhet në katalogun manual dhe shërbehet në fondin e mbyllur për t'u studiuar në sallën e leximit me fonde të hapura përgjatë orarit 8:00 – 19:00. Ndërsa periodiku koherent, rekorde bibliografike me të dhëna të hollësishme mbi përmbajtjen, kërkimi bëhet online, kurse shërbim ofrohet në fondi i mbyllur dhe shfletohet në sallën e leximit me fonde të hapura përgjatë orarit 8:00 – 19:00. *Evidenca 5.15 Lista përfshirëse e titujve fizikë në bibliotekën e UART.* |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. | Rezulton se, institucioni ka krijuar mundësi për aksesim e studentëve në platformën on-line të bibliotekës ku mund të paraqesin kërkesat e tyre për shfrytëzimin e librave fizik dhe digjital. Institucioni i ofron studentëve mundësi aksesimi nëpërmjet abonimit në revista shkencore online si:<br><br>◦ Years 2007 – Grover Music;<br><br>◦ Years 2008 -2013 - Cambridge journals online; Oxford English Dictionary online;<br><br>Oxford reference online;<br><br>◦ Years 2012 – 2013 - Alexander Street Press; Jstor; Muse; Wiley;<br><br>AKSH - Ebscohost<br><br>For free access<br><br>▪ IMSLP – Petruci Music Library. http://imslp.org/<br><br>▪ ILSan – Il sistema Archivistico Nazionale.<br><br>http:// san.beniculturali.it |

| | |
|---|---|
| | ▪ Culturetheque Instituti Francais<br><br>www.culturetheque.com<br><br>si dhe nëpërmjet katalogut online të Bibliotekës universitare uart.edu.al/katalog_biblio dhe arkivës dixhitale të Bibliotekës së Universitetit të Arteve arkiv.uart.edu.al.<br><br>*Evidenca 5.14 Lista e burimeve elektronike në të cilat ka akses UART në rrugë digjitale.* |
| **Kriteri 7.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | Gjatë vizitës në institucion, konstatuam se, Biblioteka funksionon nëpërmejt Regjistrit themeltar të inventarit të koleksioneve bibliotekare, i cili është dokumenti bazë që pasqyron të gjitha materialet bibliotekare që kanë hyrë në bibliotekë që në krijimin e saj në mënyrë kronologjike. Regjistri i inventarit është dokument mbi bazën e të cilit bëhet inventari i bibliotekës. Në të rregjistrohet çdo njësi që hyn në biblioteke dhe merr një numër që e identifikon atë si njësi unike midis tërë koleksionit të bibliotekës.<br><br>Biblioteka ka vënë në dispozicion të studentëve aksesimin nëpërmjet katalogu online të Bibliotekës së Universitetit të Arteve uart.edu.al/katalog_biblio dhe arkivës dixhitale të Bibliotekës së Universitetit të Arteve arkiv.uart.edu.al si dhe oraret e shërbimit, për të qënë në dispozocion të nevojave të studentëve. Biblioteka punon përgjatë orarit 8:00 – 19:00.<br><br>*Evidenca 5.14 Lista e burimeve elektronike në të cilat ka akses UART në rrugë digjitale.*<br><br>*Evidenca 5.15 Lista përfshirëse e titujve fizikë në bibliotekën e UART.*<br><br>*Evidenca 5.16 Lista e pajisjeve të Bibliotekës së UART.* |
| **Kriteri 8.** Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), | Konstatojmë se, biblioteka dhe njësitë bazë kanë një komunikim të vazhdueshëm për pasurimin e fondit fizik dhe elektronik të fondit të titujve. Njësia kryesore me propozim nga njësia bazë çdo fillim viti akademik paraqet listën e kërkesave të titujve për pasurimin e fondit të titujve në shërbim të realizimit të programeve të studimit që ofron. *Evidenca 5.12.3 Biblioteka lista e kërkesave.* |

| | |
|---|---|
| përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik. | Biblioteka bën përditësime periodike për shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit nëpërmjet Arkivës Dixhitale të BSHUA, nga ku rezulton se, për vitin akademik 2021-2022 kanë shftytëzuar fondit online të bibiotekës 1073 përdorues, nga të cilët 704 nga Shqipëria,148 nga Kosova, 46 nga USA, 26 nga Italia etj.<br><br>*Evidenca 5.18.4 DSPACE ANALYTICS 20220101-20220701 - Statistika të aksesit të Bibliotekës së UART.* |
| **Konkluzione** | *Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë se, Biblioteka e UART ka një fond shumë të pasur fizik dhe elektrinik me tekste mësimore në gjuhën shqipe dhe të huaj si dhe doreshkrime, libra dhe revista shkencore të nevojshme, të përshtatshme për mbulimin e kurseve dhe veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës të programit të studimit, por vërehet një mungesë fondi specifik dedikuar kurseve të karakter psiko-pedagogjik që ofrohen në të gjitha programet e ciklit të dytë të studimeve që ofrohen në këtë institucion, si rrjedhojë:*<br><br>*<u>Rekomandohet</u> shtimi i fondit të teksteve fizik dhe elektronik në fushën e edukimit (literature bazë dhe e këshillueshme) për plotësimin e nevojave të studenteve në realizimin e leksioneve, detyrave dhe projekteve të kurseve me karakter psiko-pedagogjik që ky program studimi ofron për formumin e mësuesve të ardhshëm.*<br><br>*Sa më sipër, ky standard përmbushet kryesisht.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi IV.4** |
|---|

| Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | Konstatojmë se UART, përdor sistemin PITAGORA.<br>Gjithashtu, konstatuam që sekretaria mësimore disponon statistika vjetore:<br>• për numrin e regjistrimeve në çdo vit akademik sipas progameve të studimit dhe cikleve të studimit;<br>• të dhëna të detajuara në lidhje me numrin e studentëve të secilit viti akademik;<br>• të dhëna për transferimet dhe çregjistrimet;<br>• të dhëna për ecurinë akademike të studentit;<br>• numrin e ECTS të grumbulluara për secilin vit akademik;<br>• të dhënat e studentëve që diplomohen.<br>*Evidenca 4.11 Screenshot nga sistemi PITAGORA.*<br>*Evidenca 5.19 VSA Nr. 23, dt. 07.10.2021 Rregullorja e funksionimit të Sekretarisë Mësimore FAS.* |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | Bazuar në Raportin vjetor të punës artistike mësimore-shkencore të stafit akademik të UART, rezulton se institucioni disponon informacion të plotë për aktivitetin mësimor dhe atë kërkimor-shkencor të personelit akademik.<br>Ndërsa në listën e marrëveshjeve në funksion të programit të studimit shprehet qartë aktiviteti që insitucioni ka, në rang njësie kryesore dhe njësie bazë me partnerët të cilët janë të angazhuar në realizimin e këtij programi studimi.<br>Drejtoria e Burimeve Njerëzore, disponon dhe arkivon dokumentacionin për personelin akademik, personelin ndihmës akademik, personelin administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Ndërsa Departamenti monitoron dhe nxit aktivitetin mësimor dhe kërkimor-shkencor. |

| | |
|---|---|
| | *Evidenca 6.11 Raporti vjetor i punës artistike mësimore-shkencore i stafit akademik të UART për vitin akademik 2020-2021.*<br>*Evidenca 5.2 Pasqyrat e ngarkesave Mësimore të angazhimit vjetor të Stafit Akademik FAS 2021 -2022.*<br>*Evidenca 4.3 Të dhëna të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik FAS.*<br>*Evidenca 4.4 Raporti vjetor i punës artistike-mësimore-shkencore i stafit akademik të FAS për vitin akademik 2019-2020.* |
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | Nga takimi me sekretarinë mësimore, konstatuam se ajo ruan të gjithë dokumentacionin e domosdoshëm për çdo student në versionin fizik dhe i hedh këto të dhëna elektronikisht në formatin e Regjistrit Themeltar të Studentëve dhe Regjistrin e Diplomimit.<br>*Evidenca 5.19 VSA Nr. 23, dt. 07.10.2021 Rregullorja e funksionimit të Sekretarisë Mësimore FAS.* |
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. | Nëpërmjet sistemit PITAGORA, rezulton se institucioni menaxhon sistemin e regjistrimeve, kurrikulën, grafikun e provimeve online, hedhjen dhe ruajtjen e vlerësimit, fazën e paradiplomimit dhe diplomimit. Studentëve u jepen të dhënat e aksesit të llogarive individuale për regjistrimin përfundimtar në mënyrë që ata te aksesojnë atë në çdo kohë, nga çdo pajisje që ka lidhje interneti. Sekretaria mësimore mban në sistem edhe të dhëna personale të studentëve si numra telefoni, adresa emaili dhe ruan kontakte të vazhdueshëm me studentët në raste njoftimesh. Të dhënat personale të tyre si datëlindja, qyteti i lindjes, adresa kontakti, etj.<br>*Evidenca 5.19 VSA Nr. 23, dt. 07.10.2021 Rregullorja e funksionimit të Sekretarisë Mësimore FAS.* |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të | Bazuar në Rregulloren e UART dhe DAT, si dhe të dhënave, të evidentuara në institucion, rezulton se institucioni garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ, në hedhjen në kohë të dokumentacionit të këkruar, përmbushjen e zhvillimit të leksioneve dhe aktiviteteve të tjera mësimore. |

| | |
|---|---|
| dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. | *Evidenca 2.7 VSA Nr. 20 dt. 07.10.2021, Miratimi i Rregullores së UART.*<br><br>*Evidenca 2.4.1 Rregullore e veprimtarisë së përgjithshme e Dep. Aktrim dhe Teori.* |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe. | Konfirmojmë që, në faqen zyrtare të internetit të UART janë publikuar të dhëna në lidhje me strukturën organizative, stafin akademik, veprimtaritë, bazën ligjore, kurrikulat dhe kalendarin akademik, kriteret e përzgjedhjes së studentëve si dhe njoftimet të ndryshme që lidhen me veprimtarinë akademike të UART, në dy gjuhë: shqip dhe anglisht.<br><br>http://www.uart.edu.al/index.php?lang=1<br><br>http://www.uart.edu.al/index.php?lang=2 |
| **Konkluzione** | *Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë se institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet sistemit Pitagora, duke administruar të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre. Konstatojmë, gjithashtu, se institucioni garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ, në hedhjen në kohë të dokumentacionit të kërkuar, në faqen e tyre zyrtare të web-it në gjuhën shqipe dhe atë angleze duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.*<br><br>*Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi IV.5**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë | Bazuar në RVB, institucioni harton çdo fillim viti buxhetin financiar i cili, pasi hartohet nga Administratori, miratohet nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, ku deklarohen |

| | |
|---|---|
| përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | kostot e shpenzuara, të ardhurat dhe përcaktimi i mbulimit financiar për programet e studimit dhe njësinë bazë.<br><br>UART, harton çdo vit një raport në lidhje me transparencën financiare, ku pasqyrohen të dhënat dhe gjendja financiare. Në raport pasqyrohen të dhëna finaciare në lidhje me koston për secilin program studimi, duke bërë kështu edhe një vlerësim të ecurisë dhe vazhdimësisë së programeve, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e vendosura. Në to përfshihet kosto për çdo program studimi, kostot operacionale dhe të mirëmbajtjes, etj.<br><br>*Evidenca 3.18 Dosja e buxhetit nga Drejtoria ekonomike.*<br><br>*Evidenca 5.26 Relacion mbi projekt-buxhetin nga administratori i FAS.*<br><br>*Evidenca 5.29 Pasqyrimi financiar vjetor i vitit 2020 UART.* |
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e [illegible] | Konfirmojmë që, institucioni ka paraqitur një plan financiar për këtë program studimi. Ndersa plani i financimit të dërguar për këtë program studimi specifikon shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, gjithashtu shpenzimet për fondin e bibliotekës, si dhe shërbimeve të lidhura me procesin mësimor dhe shkencor të Departamentit.<br><br>*Evidenca 5.29 Pasqyrimi financiar vjetor i vitit 2020 UART.* |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. | Konstatuam që, UART, nuk i është nënshtruar një auditimi financiar, për shkak se disponon një strukturë të posaçme për realizimin e Auditit të brendshëm, siç parashikon VKM Nr. 83, Datë 03.02.2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik". |
| **Kriteri 4.** Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi | Konstatojmë se, në mbyllje të çdo viti kalendarik, institucioni dokumenton raportin financiar për 1 vit kalendarik dhe konstatojmë se në bilancin e vënë në dispozicion, pasqyrohen të |

| | |
|---|---|
| realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. | gjitha të dhënat përsa i përket realizimit të buxhetit, si dhe shpenzimeve të kryera.<br>*Evidenca 5.26 Relacion mbi projekt-buxhetin nga administratori i FAS.*<br>*Evidenca 5.29 Pasqyrimi financiar vjetor i vitit 2020 UART.* |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve. | Konstatojmë se, bilanci i vënë në dispozicion nga institucioni dëshmon se UART, garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen, për këtë program studimi nëpërmjet aplikimit në projekte të ndryshme fitimprurëse.<br>*Evidenca 3.17 Model aplikimi projekti nga FAS, shtojca 2.*<br>*Evidenca 5.26 Relacion mbi projekt-buxhetin nga administratori i FAS.*<br>*Evidenca 5.29 Pasqyrimi financiar vjetor i vitit 2020 UART.* |
| **Konkluzione** | *Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë se institucioni harton çdo vit një raport në lidhje me transparencën financiare, ku pasqyrohen të dhënat dhe gjendja financiare, ku përfshihen kostot për çdo program studimi, kostot operacionale dhe të mirëmbajtjes, duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.*<br>*Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | Në përputhje me legjislacionin në fuqi, UART ka hartuar statutin dhe rregulloren e universitetit, të cilat përcaktojnë dhe specifikojnë politikat dhe proçedurat që ndjek institucioni për pranimin, transferimin apo largimin e studentëve nga programi i studimit. GVJ përmes dokumentacionit të dorëzuar konfirmon që këto akte janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Diplomimi i studentëve bëhet në përputhje me rregulloren e programit të studimit.<br><br>*Evidenca 2.17.2 - Urdher Masr, Bashkëngjitur Statutit Uart _2021*<br><br>*Evidenca 2.7 VSA Nr. 20 dt. 07.10.2021, Miratimi i Rregullores së UART*<br><br>*Evidenca 2.5.1 Rregullorja e programit të studimit MA Aktrim & Teori dhe Mësuesi.* |
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | Konstatojmë që institucioni ka ngritur komisionet përkatëse, pranë departamentit, ku nëpërmjet Rregullores së Regjistrimeve dhe Transferimeve ka hartuar politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje duke garantuar barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë në këtë program studimi. Konfirmojmë që procedurat dhe kriteret e pranimit janë konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe në përputhje me politikat e hartuara nga institucioni.<br><br>*Evidenca 2.5.1 Rregullorja e programit të studimit MA Aktrim & Teori dhe Mësuesi.*<br><br>*Evidenca 2.2 Rregullorja e ciklit të II të studimit Master në UART* |
| **Kriteri 3.** Institucioni harton dhe publikon përpara | Rezulton se përpapa fillimit të çdo viti akademik institucioni me propozim nga DAT dhe miratim nga Senati Akademik, harton |

| | |
|---|---|
| çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. | kriteret dhe procedurat për hyrjen në programin e studimit "Master i Arteve në Aktrim dhe Mësuesi", duke garantuar shance të barabarta për të gjithë kandidatët nëpërmjet shpërndarjes së kuotave për kategori të veçanta si për kandidatët për studentë nga trojet, pakicat kombëtare si dhe personat me aftësi të veçanta.<br><br>*Evidenca 2.5.1 Rregullorja e programit të studimit MA Aktrim & Teori dhe Mësuesi.*<br><br>*Evidenca 2.2 Rregullorja e ciklit të II të studimit Master në UART*<br><br>*Evidenca 3.7 VSA Nr. 18 dt. 07.02.2020 "Mbi miratimin e Rregulloreve, Kritereve për zhvillimin e konkursit për vitin akademik 2021-2022 FAS"* |
| **Kriteri 4.** Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | Konstatojmë se institucioni harton dhe publikon çdo vit akademik kriteret dhe kuotat e pranimit në programet e studimit që ofron UART, sipas legjislacionit në fuqi dhe i publikon ato online. UART, ka hartuar politika të qarta për promovimin dhe informimin e kandidatëve për student për programet dhe mundësitë për studim që ofron.<br><br>*Evidenca 2.2 Rregullorja e ciklit të II të studimit Master në UART*<br><br>Konstatojmë që programet e studimit, të detajuara me lëndët dhe modulet që përmban, i bëhen të ditura studentit që në momentin e regjistrimit. Ato janë të publikuara në faqen e internetit të UART, sipas fakulteteve përkatëse<br><br>(http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=62&niveli=47)<br><br>Në fillim të vitit akademik studentët familjarizohen me materiale udhëzuese si:<br><br>• Rregullorja e ciklit të II të studimit Master, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e UART dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretaritë mësimore, periudhën dhe kohëzgjatjen e studimeve, regjistrimet dhe transferimet, pjesëmarrjen në veprimtaritë mësimore, vlerësimin dhe diplomimin.<br><br>*Evidenca 2.2 Rregullorja e ciklit të II të studimit Master në UART* |

| | |
|---|---|
| | • Manuali i transferimeve të studentëve, ku studenti gjen informacion të plotë mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin e studentëve<br><br>*Evidenca 6.16 Manuali i transferimeve të studentëve UART*<br><br>• Syllabuset e moduleve përkatëse për çdo semester nga lektori i lëndës në të cilat janë të specifikuara kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve për çdo modul në veçanti dhe modalitetet e diplomimit tyre në programin e studimit.<br><br>*Evidenca 3.1- Planet Mesimore FAS*<br><br>• Kurrikulën e Programit të Studimit Master i Arteve Aktrim dhe Mësuesi<br><br>*Evidenca 3.1- Planet Mesimore FAS*<br><br>• Rregullorja e Programit të Studimit Master i Arteve Aktrim dhe Mësuesi, përcakton qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit nga njëri vit në tjetrin. Gjithashtu, nëpërmjet Rregullores së Programit të Studimit Master i Arteve Aktrim dhe Mësuesi, përcaktohen qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit të vitit akademik dhe manuali i rekrutimeve, aplikimeve, regjistrimeve dhe transferimeve, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e UART dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretaritë mësimore, periudhën dhe kohëzgjatjen e studimeve, regjistrimet dhe transferimet, pjesëmarrjen në veprimtaritë mësimore, vlerësimin dhe diplomimin.<br><br>*Evidenca 2.5.1 Rregullorja e programit të studimit MA Aktrim & Teori dhe Mësuesi*<br><br>Konstatojmë se bazuar në Rregulloren e UART, në Rregulloren e programit të studimit, Rregulloren e ciklit të II të studimit Master, Manualin e transferimeve të studentëve si dhe syllabuset e moduleve përkatëse për çdo semestër nga lektori i lëndës janë të specifikuara kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve për çdo modul në veçanti dhe modalitetet |

| | |
|---|---|
| | e diplomimit të tyre në programin e studimit Master i Arteve Aktrim dhe Mësuesi.<br>*Evidenca 2.7 VSA Nr. 20 dt. 07.10.2021, Miratimi i Rregullores së UART*<br>*Evidenca 2.2 Rregullorja e ciklit të II të studimit Master në UART*<br>*Evidenca 2.5.1 Rregullorja e programit të studimit MA Aktrim & Teori dhe Mësuesi*<br>*Evidenca 3.1- Planet Mesimore FAS* |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. | Rezulton se institucioni, përpara fillimit të çdo viti akademik publikon online kriteret e pranimit për secilin program studimi. (http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=549&niveli=124)<br>*Evidenca 3.8 Kriteret e miratuara me vendim Senati për zhvillimin e konkursit të të dy cikleve të studimit 2020- 2021, 2021-2022, 2022-2023.*<br>Plani i programit të studimit i bëhet e ditur studentit që në momentin e regjistrimit. Në faqen e internetit të UART, gjenden në çdo kohë plan programet për çdo program studimi:<br>http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=62&niveli=47 |
| **Kriteri 6.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara. | Konstatojmë se institucioni harton dhe publikon çdo vit akademik kriteret dhe kuotat e pranimit për programet e studimit që UART ofron, sipas legjislacionit në fuqi dhe i publikon ato online. UART, ka hartuar politika të qarta për promovimin dhe informimin e kandidatëve për student për programet dhe mundësitë për studim që ofron.<br>*Evidenca 3.7 VSA Nr. 18 dt. 07.02.2020 "Mbi miratimin e Rregulloreve, Kritereve për zhvillimin e konkursit për vitin akademik 2021-2022 FAS"* |
| **Kriteri 7.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. | Rezulton se institucioni, përpara fillimit të çdo viti akademik publikon online kriteret e pranimit për secilin program studimi. (http://www.uart.edu.al/).<br>Plani i programit të studimit i bëhet e ditur studentit që në momentin e regjistrimit. Në faqen e internetit të UART, gjendet në çdo kohë Rregulloret dhe Kriteret per pranimin e studenteve |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | (http://uart.edu.al/media/Rregulloret%20dhe%20kriteret%20MASTER%202022-2023%20FAS.pdf) | | | |
| **Kriteri 8.** Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. | UART ka hartuar politika mbështetëse për shtresa në nevojë të komunitetit Romë, Ballkano dhe Egjiptianë si dhe jep bursa për shtresat në nevojë dhe studentët ekselentë bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke i publikuar ato në faqen e internetit:<br>http://uart.edu.al/index.php?id=1138<br>*Evidenca 6.5 VBA Nr. 28 datë 30.12.2021 "Për reduktimin me 50 % të tarifës vjetore të shkollimit për studentët e ciklit të dytë".*<br>*Evidenca 6.6 VKM Nr 780, dt. 26.12. 2018 " Për përcaktimin e kategorive të individëve për ulje tarife"*<br>*Evidenca 3.9 VKM Nr. 251 dt. 27.03.2020 për një ndryshim në VKM nr. 269 dt. 29.03.2017 për përjashtimin nga pagesa të studentëve; Romë-Ballkano –Egjiptianë.* | | | |
| **Konkluzione** | *Nga vizita në institucion dhe evidancat, konstatojmë se institucioni harton dhe publikon çdo vit akademik kriteret dhe kuotat e pranimit në programet e studimit që ofron UART, sipas legjislacionit në fuqi dhe i publikon ato online ne faqen zyrtare të web-it.*<br>*Gjithashtu, konstatojmë se UART, ka hartuar politika të qarta për promovimin dhe informimin e kandidatëve për studentët si dhe ka hartuar politika mbështetëse për shtresa në nevojë duke dhënë bursa për to dhe studentët ekselentë bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| | |
|---|---|
| **Standardi V.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | Konstatojmë që programet e studimit, të detajuara me lëndët dhe modulet që përmban, i bëhen të ditura studentit që në momentin e regjistrimit. Ato janë të publikuara në faqen e internetit të UART, sipas fakulteteve përkatëse.<br><br>http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=7&niveli=41<br><br>Në fillim të vitit akademik studentët familjarizohen me materiale udhëzuese si:<br><br>• Rregullorja e ciklit të II të studimit Master, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e UART dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretaritë mësimore, periudhën dhe kohëzgjatjen e studimeve, regjistrimet dhe transferimet, pjesëmarrjen në veprimtaritë mësimore, vlerësimin dhe diplomimin.<br><br>*(Evidenca 2.2 Rregullorja e ciklit të II të studimit Master në UART)*<br><br>• Rregullorja e Programit të Studimit Master i Arteve Aktrim dhe Mësuesi, përcakton qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit nga njëri vit në tjetrin. Gjithashtu, nëpërmjet Rregullores së Programit të Studimit Studimit Master i Arteve Aktrim dhe Mësuesi, përcaktohen qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit të vitit akademik dhe manuali i rekrutimeve, aplikimeve, regjistrimeve dhe transferimeve, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e UART.<br><br>*( Evidenca 2.5.1 Rregullorja e programit të studimit MA Aktrim & Teori dhe Mësuesi)*<br><br>• Syllabuset e moduleve përkatëse për çdo semester nga lektori i lëndës në të cilat janë të specifikuara kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve për çdo modul në veçanti dhe modalitet e diplomimit tyre në programin e studimit.<br><br>*(Evidenca 3.1- Planet Mesimore FAS)*<br><br>• Kurrikulën e Programit të Studimit Master i Arteve Aktrim dhe Mësuesi |

| | |
|---|---|
| | *(Evidenca 3.1- Planet Mesimore FAS)* |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | Nëpërmjet Rregullores se Programit të Studimit Master i Arteve Aktrim dhe Mësuesi, përcaktohen qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit të vitit akademik dhe manuali i rekrutimeve, aplikimeve, regjistrimeve dhe transferimeve, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e UART dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretaritë mësimore, periudhën dhe kohëzgjatjen e studimeve, regjistrimet dhe transferimet, pjesëmarrjen në veprimtaritë mësimore, vlerësimin dhe diplomimin.<br>*(Evidenca 2.5.1 Rregullorja e programit të studimit MA Aktrim & Teori dhe Mësuesi)* |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | Konstatojmë se bazuar në Rregulloren e UART, në Rregulloren e ciklit të II të studimit Master dhe syllabuset e moduleve përkatëse për çdo semestër nga lektori i lëndës janë të specifikuara kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve për çdo modul në veçanti dhe modalitetet e diplomimit të tyre në programin e studimit Master i Arteve Aktrim dhe Mësuesi.<br>*(Evidenca 2.5.1 Rregullorja e programit të studimit MA Aktrim & Teori dhe Mësuesi)*<br>*(Evidenca 6.16 Manuali i transferimeve të studentëve UART)*<br>*(Evidenca 3.1- Planet Mesimore FAS)* |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | Në Rregulloren e Programit të Studimit "Master i Arteve Aktrim dhe Mësuesi., janë të përcaktuara qartë kriteret dhe procedurat e diplomimit në këtë program studimi.<br>*(Evidenca 2.5.1 Rregullorja e programit të studimit MA Aktrim & Teori dhe Mësuesi)* |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të | Nga shqyrtimi i RVB dhe vizitat në institucion, u informuam se DAT, në fillim të vitit të parë të studimeve në bashkëpunim me Këshillimin e Karrierës dhe Alumni, organizon javën orientuese me studentët e rinj gjatë të cilit prezantohet stafi akademik i përfshirë në programin e studimit, jepet infomacion rreth plan |

| | |
|---|---|
| posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. | programit dhe orientohen në lidhje me vendndodhjen e auditorëve, zyrave dhe sekretarive, oraret e shfrytëzimit të bibliotekës.<br>*Evidenca 6.7 Rregullorja e Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, UART* |
| **Konkluzione** | *Nga vizita në institucion dhe evidancat, konstatojmë që programet e studimit, të detajuara me lëndët dhe modulet që përmban program i studimit i bëhen të ditura studentit që në momentin e regjistrimit. Nëpërmjet Rregullores se Programit të Studimit Master i Arteve Aktrim dhe Mësuesi, ku përcaktohen qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit të vitit akademik, kriteret e aplikimeve, regjistrimeve dhe transferimeve, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e UART dhe funksionin e tyre si dhe orientohen në lidhje me vendndodhjen e auditorëve, zyrave dhe sekretarive, oraret e shfrytëzimit të bibliotekës.*<br>*Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. | Konstatojmë që studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën e institucionit, organizimin, njësitë dhe organet përgjegjëse për marrjen e informacionit për mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt tregut të punës. Komunikim i brendshëm mes studentëve, stafit akademik dhe sekretarisë mësimore realizohet nëpërmjet Sistemit Petagora. Aty studenti mund të aksesojë në çdo kohë informacionin e nevojshëm në lidhje me format e vlerësimit për |

| | |
|---|---|
| | secilën lende, informacion në lidhje me frekuentimin, grafikun e provimeve, auditorët, etj.<br><br>*Evidenca 4.11 Screenshot nga sistemi PITAGORA* |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | Rezulton se në fillim të vitit akademik studentët pajisen me materiale si Rregullorja e Programit të Studimit Master i Arteve Aktrim dhe Mësuesi, përcakton qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit nga njëri vit në tjetrin, por nuk diponojnë një manual/udhëzues për studentët. Sezonet e provimeve, riprovimeve dhe sezonet e mbartura u bëhen të ditura studentëve që në fillim të vitit akademik, të cilat publikohen në faqen zyrtare të UART.<br><br>*Evidenca 2.5.1 Rregullorja e programit të studimit MA Aktrim & Teori dhe Mësuesi* |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. | Konstatojmë se Njësia e Karrierës dhe Alumnit informon studentët mbi mundësitë e punësimit dhe mbështetjen institucionale të tregut të punës. Njësia e Karrierës dhe Alumnit orienton studentët për zgjedhjen e karrierës së tyre, rritjen e kontakteve, vetëpunësimin dhe mundësitë për tregun e punës si dhe i përfshin ata në aktivitete të ndryshme artistike që institucioni organizon.<br><br>*Evidenca 6.13 Pjese nga Database i studenteve te punesuar te RAT*<br><br>*Evidenca 6.7 Rregullorja e Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, UART*<br><br>*3.16 Dosja e repertorit të shfaqjeve_filmave të pedagogëve të FAS, studentë aktualë dhe ALUMNI FINAL* |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | Çdo fillim të vitit të parë të studimeve, DAT, në bashkëpunim me Njësinë e Karrierës dhe Alumnit, organizojnë javën orientuese me studentët e rinj gjatë të cilit prezantohet stafi akademik i përfshirë në programin e studimit, jepet infomacion rreth plan programit dhe orientohen në lidhje me vendndodhjen e auditorëve, zyrave dhe sekretarive, oraret e shfrytëzimit të bibliotekës. Në faqen e internetit të UART, gjithashtu gjendet i publikuar informacion i plotë për strukturat e UART dhe |

| | |
|---|---|
| | funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretaritë mësimore, bibliotekën, laboratorët etj.<br>*http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=44&niveli=3* |
| **Kriteri 5.** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë. | Konstatojmë se informimi i studentëve, realizohet nëpërmjet platformës Microsoft Teams dhe Pitagora, sikurse pohuan edhe vetë studentët gjatë takimit fizik, arrijnë të ndërveprojnë gjatë realizimit të procesit mësimor, platforma të cilat kanë shërbyer për zhvillimin e procesit mësimor dhe artisitk edhe gjatë periudhës së Pandemisë. Ndërsa informacioni mbi kurrikulat e studimit, aktivitet dhe kalendarin mësimor publikohen online dhe janëlehtësisht të arritshëm nga studentët në distancë.<br>*Evidenca 4.9 Manuali i përdorimit të sistemit Microsoft Teams*<br>*Evidenca 4.11 Screenshot nga sistemi PITAGORA* |
| **Konkluzione** | *Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatojmë që në faqen e internetit të UART gjendet i publikuar informacion i plotë për strukturat e UART dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretaritë mësimore, bibliotekën, laboratorët*<br>*Njësia e Karrierës dhe Alumnit informon dhe orienton studentët mbi mundësitë për tregun e punës si dhe i përfshin ata në aktivitete të ndryshme artistike që institucioni organizon.*<br>*Rezulton se në fillim të vitit akademik studentët pajisen me materiale si Rregullorja e Programit të Studimit Master i Arteve Aktrim dhe Mësuesi, përcakton qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit nga njëri vit në tjetrin.*<br>*Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.4** |
|---|
| **Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.** |

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| --- | --- |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit. | Nga shqyrtimi i Raportit të Vetëvlerësimit të Programit dhe Plani stategjik për zhvillimin e insitutcionit, kostatojmë se institucioni paraqet raporte vjetore për veprimtarinë e kryer.<br>*Evidenca 2.6 Mbi miratimin e planit të zhvillimit strategjik të UART për vitet akademike 2018-2025.*<br>Konstatojmë, gjithashtu, që institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve dhe të diplomuarve për secilin program studimi që UART ofron. Referuar RVB specifikisht për programin Master i Arteve në Aktrim dhe Mësuesi, rezultojnë të regjistruar:<br>• për vitin akademik **2019-2020** në total **8 studentë;**<br>• për vitin akademik **2020-2021** në total **7 studentë;**<br>• për vitin akademik **2021-2022** në total **6 studentë;**<br>*Evidenca 6.19 Të dhëna statistikore FAS.* |
| **Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. | Nga shqyrtimi i RVB dhe Rregullorja e Veprimtarisë së Përgjithshme dhe asaj Mësimore të Fakultetit të Artit Skenik, rezulton se Sekretaria Mësimore është zyra e cila është përgjegjëse për menaxhimin e procesit të regjistrimit të studentëve, për rregullimin, monitorimin dhe arkivimin e çdo regjistrimi, informacioni, dokumenti apo transkripti lidhur me studentët. Nga vizita në institucion me sekretarinë mësimore konstatuam **se** ajo disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit, notës mesatre hyrëse dhe dalëse, gjithashtu administron dhe ruan të dhënat mësimore të studentëve dhe të procesit mësimor në regjistrin themelar të studentëve, sipas legjislacionit ne fuqi.<br>*Evidenca 4.8 VSA 35 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Artit Skenik*<br>*Evidenca 6.19 Të dhëna statistikore FAS*<br>Nga vizita në institucion me përfaqësues të Njësisë së Karrierës dhe Alumnit (NjKA) konstatuam se ajo mban kontakte me studentët e diplomuar duke krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre. Rezulton se NjKA në bashkëpunim me |

| | |
|---|---|
| | sektorn mësimor, bazuar edhe në Rregulloren e Rregullorja e Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar konsulencë për çështje akademike, mobilitet studentor si dhe informacion në lidhje me mundësi punësimi, apo/edhe aktivitete studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit.<br>*Evidenca 6.7 Rregullorja e Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, UART* |
| **Kriteri 3.** Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. | Nga vizita në institucion rezultoi se sekretaria mësimore e FAS disponon statistika vjetore për numrin e regjistrimeve në çdo vit akademik sipas progameve të studimit dhe cikleve të studimit. Gjithashtu ajo ruan të dhëna të detajuara në lidhje me numrin e studentëve të secilit vit akademik, transferimet dhe çregjistrimet, ecurinë akademike të studentit, numrin e ECTS të grumbulluara për secilin vit akademik, si dhe të dhënat e studentëve që diplomohen. Sekretaria ruan dokumentacionin e domosdoshëm për çdo student në versionin fizik dhe i hedh këto të dhëna elektronikisht në sistemin Pitagora dhe database-n Excel që disponon.<br>*Evidenca 5.19 VSA Nr. 23, dt. 07.10.2021 Rregullorja e funksionimit të Sekretarisë Mësimore FAS*<br>*Evidenca 6.19 Të dhëna statistikore FAS*<br>*Evidenca 4.11 Screenshot nga sistemi PITAGORA* |
| **Kriteri 4.** Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që | Bazur ne Rregulloren e funksionimit të Sekretarisë Mësimore FAS si dhe ne Rregullorja e Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, UART rezulton se institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse si sekretaritë mësimore, sektoret e Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni.<br>*Evidenca 5.19 VSA Nr. 23, dt. 07.10.2021 Rregullorja e funksionimit të Sekretarisë Mësimore FAS* |

| | |
|---|---|
| lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. | *Evidenca 2.3 VSA 35 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Artit Skenik* |
| **Kriteri 5.** Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. | Konstatojmë se institucioni harton në mënyrë periodike raporte vjetore në rang njësie bazë. Sekretaria Mësimore gjithashtu disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit, notën mesatare hyrëse dhe dalëse, por:<br>*Institucioni nuk ka paraqitur një raport analitik periodik mbi cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre.*<br>*Evidenca 6.19 Të dhëna statistikore FAS* |
| **Konkluzione** | *Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatojmë që institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit, notës mesatre hyrëse dhe dalëse, gjithashtu administron dhe ruan të dhënat mësimore të studentëve dhe të procesit mësimor në regjistrin themelar të studentëve, sipas legjislacionit ne fuqi, por institucioni nuk ka paraqitur një raport analitik periodik mbi cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve | Konstatojmë që studentët e UART janë të përfshirë në vendimmarrje, këshillim dhe vlerësimin mbi procesin akademik në organet kolegjiale të insitucionit. Ata kanë përfaqësues në |

| | |
|---|---|
| dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. | Senatin Akademik, në Këshillin e Etikës si dhe në Grupet e vlerësimit të brendshëm si dhe gjithashtu janë pjesë e komisionit të marrëdhënieve me studentëtm, ngritur në tetor të vitit 2021 në rang institucional.<br>*Evidenca 1.15.1 VSA Nr. 12 dt. 07.07.2021 ""Për miratimin e Statutit të UART"*<br>*Evidenca 1.18 Urdhëri FAS Nr. 01, dt. 10.03.2022, Për ngritjen e grupeve të punës për vlerësimin e brendshëm, në kuadër të akreditimit të programeve të ciklit të dytë master në FAS.*<br>*Evidenca 6.8 VSA Nr. 22, datë 07.10.2021 Mbi miratimin e rregullores së funksionimit të komisionit të marrëdhënieve me studentët"* |
| **Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | Rezulton që institucioni është i angazhuar që të garantojë përfshirjen e studentëve në vendimmarrje nëpërmjet përqafësuesve në Senatin Akademik, në grupin e ngritur nga NjZHKC për hartimin e GVB në kuadër të sigurimit të cilësisë. Mungon evidenca per ngritjen e Këshilleve Studentore.<br>*Evidenca 1.15.1 VSA Nr. 12 dt. 07.07.2021 ""Për miratimin e Statutit të UART"*<br>*Evidenca 1.18 Urdhëri FAS Nr. 01, dt. 10.03.2022, Për ngritjen e grupeve të punës për vlerësimin e brendshëm, në kuadër të akreditimit të programeve të ciklit të dytë master në FAS.* |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj. | Konstatojmë se studentët janë të përfshirë në takimet e organizuara nga Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, që kanë për detyrë të monitorojnë cilësinë e zbatimit të kurrikulës në cikle të ndryshme të studimit si dhe të mbështesin punën e njësive bazë për akreditimin, hartimin e programeve të reja të studimit etj, si dhe janë pjesë e GVB, për hartimin e RVB për Programin e Studimit Master i Arteve Aktrim dhe Mësuesi.<br>*Evidenca 1.18 Urdhëri FAS Nr. 01, dt. 10.03.2022, Për ngritjen e grupeve të punës për vlerësimin e brendshëm, në kuadër të akreditimit të programeve të ciklit të dytë master në FAS.*<br>*Evidenca 4.6 Të dhëna nga pyetësori i studentëve.PDF* |
| **Kriteri 4.** Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe | Bazuar në të dhënat e pyetësorit të studentëve, studentëve u krijohet mundësia të japin mendim mbi barazinë dhe |

| | |
|---|---|
| ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit të kontrollit të dijeve nga ana pedagogut përgjegjës.<br><br>*Konstatojme që institucioni nuk ka paraqitur instrumenteve matës që përdorin për vlerësimin e procesit mësimor, nga stafi akademik dhe pyetësori për studentët.*<br><br>*Evidenca 4.6 Të dhëna nga pyetësori i studentëve* |
| **Konkluzione** | *Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatojmë që studentët e UART janë të përfshirë në vendimmarrje, këshillim dhe vlerësimin mbi procesin akademik në organet kolegjiale të insitucionit. Ata kanë përfaqësues në Senatin Akademik, në Këshillin e Etikës si dhe në Grupet e vlerësimit të brendshëm dhe u krijohet mundësia të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit të kontrollit të dijeve nga ana pedagogut përgjegjës*<br><br>*Për sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.6**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. | Konstatojmë se institucioni paraqet procedura të qarta për informimin e studentëve nëpërmjet Sektorit Mësimor & Kurrikulës. Zyra e Informimit të Studentëve si dhe Këshillimit të Karrierës dhe Alumni angazhohen në mbështetje të studentëve përgjatë gjithë ciklit të studimeve master. DAT në bashkëpunim me zyrat e cipërcituara vënë në dispozicion të tyre, materiale dhe broshura informuese dhe orientuese si dhe çdo |

| | |
|---|---|
| | informacion tjetër të nevojshëm për programin e studimit që do të ndjekin.<br><br>*Evidenca 6.7 Rregullorja e Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, UART.PDF* |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | Konstatojmë që nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të UART dhe Sekretarisë Mësimore, studentët kanë mundësi të informohen për mënyrën e regjistrimit të tyre, kryerjen e pagesave, aksesin në sistem, prenotimin në lëndët që duhet të japin provim etj. Gjithashtu, informacione më të detajuara për profilin e tyre personal, realizohet nëpërmjet aksesit ne sistemin Pitagora.<br><br>https://uart.pitagora.rash.al/login |
| **Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | Konstatojmë se nëpërmjet Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve si dhe Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, kandidatët për student, studentët dhe alumni marrin infomacion dhe mbështetje për planifikimin e karrierës se tyre nëpërmjet trajnimeve, forumeve, projekteve, seminareve, takimeve informuese, tryezave të rrumbullakëta, aktivieteve të ndryshme artistike që institucioni organizon.<br><br>Gjithashtu ky sektor ofron informacion për bursa, informacion në lidhje me mobilitetet dhe progamet e shkëmbimeve jashtë vendit si dhe ne bashkërendim me DAT orienton studentët për zhvillimin e praktikës profesionale.<br><br>*Evidenca 6.7 Rregullorja e Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, UART*<br><br>*Evidenca 4.12 Të dhëna mbi mobilitetin e studentëve FAS*<br><br>*Evidenca 2.15 Aktivitete e përbashkëta të pedagogëve dhe studentëve në 3 vitet e fundit* |
| **Kriteri 4.** Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna | Konstatojmë që Këshillimit të Karrierës dhe Alumni ka nisur procesin e e gjurmimit të studentëve pas diplomimit duke krijuar ura bashkëpunimi ndërmjet tyre dhe studentëve aktual të institucionit. |

| | |
|---|---|
| mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. | *Evidenca 6.13 Pjese nga Database i studenteve te punesuar te DAT.* |
| **Konkluzione** | *Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatojmë që studentët kanë mundësi të informohen për mënyrën e regjistrimit të tyre, kryerjen e pagesave, aksesin në sistem, prenotimin në lëndët që duhet të japin provim. Gjithashtu, konstatojmë se nëpërmjet Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve si dhe Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, kandidatët për student, studentët dhe alumni marrin infomacion dhe mbështetje për planifikimin e karrierës se tyre nëpërmjet trajnimeve, forumeve, projekteve, seminareve, takimeve informuese, tryezave të rrumbullakëta, aktivieteve të ndryshme artistike që institucioni organizon. Për sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi VI.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton udhëzues në nivel | Universiteti i Arteve për vetë specifikën e programeve që ofron, ka hartuar Rregulloren e Veprimtarisë së Përgjithshme dhe asaj |

| | |
|---|---|
| institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. | Mësimore të Fakultetit të Artit Skenik si Rregulloren e ciklit të II të studimit Master në UART ku jepen direktiva të qarta për zhvillimin e kurrikulës dhe përdorimin e metodave bashkëkohore që duhen përdorur në procesin mësimor. Ato orientojne për punën që duhet bërë në lidhje me hartimin e sylabuseve lëndore, përzgjedhjen e literaturës, metodat bashkëkohore, sistemin e kontrollit dhe të vlerësimit të dijeve të studentëve, këshillimin akademik dhe tutoriatin, etj.<br><br>Rezulton se, institucioni ka realizuar një Marrëveshje Bashkëpunimi me Fakultetit e Shkencave Sociale, UT për trajnimin e stafit akademik për njohuri profesionale dhe akademike në fushën e formimit pedagogjik të mësimdhënies.<br><br>*Evidenca 2.2 Rregullorja e ciklit të II të studimit Master në UART*<br><br>*Evidenca 2.3 VSA 35 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Artit Skenik.*<br><br>*Evidenca 2.7 VSA Nr. 20 dt. 07.10.2021, Miratimi i Rregullores së UART.*<br><br>*Evidenca 5.1 VKM Nr. 329, datë 12.04.2017 "Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik"*<br><br>*Evidenca 4.7 Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Fakultetit të Shkencave Sociale, UT dhe Fakultetit të Artit Skenik të UART, mbi trajnimet e stafit akademik.* |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. | Nga vizita në institucion konstatuam se institucioni ka ngritur një komision ad-hoc për monitorimin dhe sigurim e cilësisë në UART. Në këtë rregullore përcaktohen rregullat për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë së institucionit dhe të programeve të studimit dhe të marrëdhënieve me strukturat e tjera brenda universitetit. Disa forma që institucioni përdor për vlerësimin e performancës së universitetit:<br><br>- Vlerësimi aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik;<br>- Raporti vjetor i punës artistike-mësimore-shkencore i stafit akademik të FAS; |

| | |
|---|---|
| | - Analiza vjetore të punës:<br>- Vlerësimi i mësimdhënies nga studentet.<br><br>*Evidenca 4.3 Të dhëna të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik FAS.*<br><br>*Evidenca 4.4 Raporti vjetor i punës artistike-mësimore-shkencore i stafit akademik të FAS për vitin akademik 2019-2020*<br><br>*Evidenca 4.5 VSA Nr. 5 dt 15.02.2021 "Mbi analizen vjetore të punës për vitin akademik 2019-2020".*<br><br>*Evidenca 4.6 Të dhëna nga pyetësori i studentëve.* |
| **Kriteri 3.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. | Sektorit Mësimor & Kurrikulës është përgjegjëse për organizimin dhe përpunimin e të dhënave që dalin nga analiza e përgjigjeve të pyetësorëve që iu drejtohen studentëve në lidhje me vlerësimin e formave të mësimdhënies, vlerësimin e dijeve të tyre, duke iu dhënë mundësi për ankimime dhe trajtim të tyre.<br><br>*Evidenca 6.7 Rregullorja e Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, UART.*<br><br>Sektorit Mësimor & Kurrikulës organizon në mënyrë periodike pyetësorët me studentët dhe i bën të ditur për stafin akademik rezultatet që dalin pas përpunimit. Këto raportime më pas dërgohen edhe në strukturat drejtuese të UART. Çdo pedagog ka të drejtën të njihet me vlerësimin që iu bëhet nga studentët.<br><br>*Evidenca 4.6 Të dhëna nga pyetësori i studentëve.* |
| **Kriteri 4.** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | Sektori Mësimor & Kurrikulës është përgjegjëse për realizimin e pyetësorëve të studentëve, për përpunimin e tyre dhe për shpalljen e rezultateve, qoftë në rrugë konfidenciale, qoftë në rrugë publike.<br><br>*Evidenca 6.7 Rregullorja e Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, UART.* |
| **Kriteri 5.** Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit | Rezultatet e vlerësimit, ndryshe nga praktikat e të kaluarës nuk shërbejnë si penalitete, por si modele që duhen përmirësuar dhe nxitur në mënyrë konstruktive. Ato i shërbejnë institucionit, departamenteve dhe vetë pedagogëve për të qenë më aktivë në |

| | |
|---|---|
| personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | planet e zhvillimit strategjik të institucionit, programit të studimit dhe lëndëve të veçanta.<br>*Evidenca 2.6 Mbi miratimin e planit të zhvillimit strategjik të UART për vitet akademike 2018-2025.*<br>*Evidenca 6.7 Rregullorja e Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, UART.* |
| **Konkluzione** | *Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë se institucioni ka ngritur një komision ad-hoc për monitorimin dhe sigurim e cilësisë në UART dhe se Sektori Mësimor & Kurrikulës organizon në mënyrë periodike pyetësorët me studentët duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.*<br>*Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. | Bazuar në Ligjin nr.80, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", rezulton se institucioni ka hartuar politika për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.<br>Sigurimi i brendshëm i cilësisë në UART bazohet në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë si dhe në Standardet Shtetërore për Sigurimin e Cilësisë. Institucioni ka ngritur një Komision Ad-Hoc për Sigurimin e Brendshëm të Standardeve të Cilësisë dhe aktualisht, organizimi strukturor i brendshëm në lidhje me sigurimin e cilësisë realizohet përmes Sektorit Mësimor & |

| | |
|---|---|
| | Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni.<br><br>*Evidenca 6.7 Rregullorja e Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, UART.*<br><br>Nga vizita në institucion dhe bazuar në organigramën e UART, rezulton se intitucioni ka në strukturë të saj njësinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, por është ende në proces realizimi.<br><br>***Rekomandohet ngritja e NJSBC dhe Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Bredshëm të Cilësisë referuar, Nenit 35 të Statutit UART.***<br><br>*Evidenca 2.17.1 Organigram of UART 2021.*<br><br>*Evidenca 1.15.2 Urdhër të MASR Nr. 319 datë 13.09.2021 "Për miratimin e Statutit të UART". Bashkëngjitur Statuti.* |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. | Konstatojmë që, institucioni ka ngritur një Komision Ad-Hoc për Sigurimit e Brendshëm të Standardeve të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku janë të përfshirë jo vetëm stafi akademik, por edhe studentët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm.<br><br>*Evidenca 1.15.2 Urdhër të MASR Nr. 319 datë 13.09.2021 "Për miratimin e Statutit të UART". Bashkëngjitur Statuti.*<br><br>*Evidenca 1.18 Urdhëri FAS Nr. 01, dt. 10.03.2022, Për ngritjen e grupeve të punës për vlerësimin e brendshëm, në kuadër të akreditimit të programeve të ciklit të dytë master në FAS.* |
| **Kriteri 3.** Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që | Konstatojmë që institucioni përdor disa instrumente matës për sigurimin e cilësisë siç janë pyetësor për studentët për matjen e cilësisë së procesit mësimor. Gjithashtu rezulton se institucioni realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit institucional, raporteve analitike të vlerësimit të brendshëm që institucioni harton.<br><br>*Evidenca 4.6 Të dhëna nga pyetësori i studentëve.*<br><br>*Evidenca 6.10 Raporti mbi gjetjet e sondazhit.* |

| | |
|---|---|
| promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit. | *Evidenca 6.11 Raporti vjetor i punës artistike mësimore-shkencore i stafit akademik të UART për vitin akademik 2020-2021.* |
| **Kriteri 4.** Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit. | Konstatojmë që, institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes si dhe arritjeve përmes sondazheve dhe raporteve vjetore që hartohen në rang institucional si dhe në nivel njësie bazë për punën artistike si dhe mësimore-shkencore të stafit akademik.<br>*Evidenca 6.12 VSA Nr. 42 datë 23.12.2021 "Për Miratimin e raportit vjetor të UART për vitin akademik 2020-2021"*<br>*Evidenca 6.10 Raporti mbi gjetjet e sondazhit.*<br>*Evidenca 6.11 Raporti vjetor i punës artistike mësimore-shkencore i stafit akademik të UART për vitin akademik 2020-2021.* |
| **Konkluzione** | *Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë se aktualisht, organizimi strukturor i brendshëm në lidhje me sigurimin e cilësisë realizohet përmes Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni. Intitucioni ka në strukturë të saj njësinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, por është ende në proces realizimi. Ndaj,* ***rekomandohet ngritja e NJSBC dhe Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Bredshëm të Cilësisë referuar Nenit 35 të Statutit UART.***<br>*Sa më sipër, ky standard përmbushet kryesisht.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi VI.3** | |
|---|---|
| **Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.<br><br>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. | Rezulton se, institucioni përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve nëpërmjet raporteve periodike të raportit të vlerësimit të brendshëm, i cili përfshin analizën e objektivave të programeve të studimit që FAS ofron, metodat e mësimdhënies, organizimin dhe administrimin e tyre si dhe format e vlerësimit, veprimtaritë artistike dhe kërkimore shkencore duke analizuar faktoret e riskut për çdo kategori.<br><br>*Evidenca 4.4 Raporti vjetor i punës artistike-mësimore-shkencore i stafit akademik të FAS për vitin akademik 2019-2020.* |
| **Kriteri 2.** Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët. | Nga shqyrtimi i Planit Strategjik të UART dhe Raporti vjetor i punës artistike-mësimore-shkencore i stafit akademik të FAS, rezulton se institucioni ka përfshirë analizën SWOT, gjatë së cilës trajtohen rezultatet e vlerësimit, rezultatet e pritshme, mangësive dhe pritshmëritë për përmirësimin në vijim të cilësisë.<br><br>*Evidenca 6.12 VSA Nr. 42 datë 23.12.2021 "Për Miratimin e raportit vjetor të UART për vitin akademik 2020-2021".*<br><br>*Evidenca 4.4 Raporti vjetor i punës artistike-mësimore-shkencore i stafit akademik të FAS për vitin akademik 2019-2020.* |
| **Kriteri 3.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e | Rezulton se institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta, si:<br><br>• Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nga studentët; |

| | |
|---|---|
| cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera. | • Fokus grupet për vlerësimin e mësimdhënies;<br>• Raportin e Vlerësimit të Programit të Studimit;<br>• Raportin vjetor të punës artistike-mësimore-shkencore i stafit akademik të FAS;<br>• Staristika të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik FAS.<br>*Evidenca 6.9 Sondazhet e bëra nga Sektori Mësimor.*<br>*Evidenca 6.10 Raporti mbi gjetjet e sondazhit.*<br>*Evidenca 4.3 Të dhëna të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik FAS.*<br>*Evidenca 4.4 Raporti vjetor i punës artistike-mësimore-shkencore i stafit akademik të FAS për vitin akademik 2019-2020.* |
| **Kriteri 4.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e | Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si:<br>1) Për vlerësimin stafit akademik nga studentët;<br>2) Për vlerësimin e procesit të mësimdhënies dhe të nxënit nga studentët;<br>3) Analizë e aktiviteteve të përbashkëta të pedagogëve dhe studentëve;<br>4) Dosja e repertorit të shfaqjeve dhe filmave të pedagogëve.<br>*Evidenca 6.9 Sondazhet e bëra nga Sektori Mësimor.*<br>*Evidenca 6.10 Raporti mbi gjetjet e sondazhit.*<br>*Evidenca 2.15.1 Aktivitetet e përbashkëta të pedagogëve dhe studentëve në 3 vitet e fundit).*<br>*Evidenca 3.16 Dosja e repertorit të shfaqjeve_filmave të pedagogëve të FAS, studentë aktualë dhe Alumni.* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| kompetencave të përftuara nga ky program. | | | | |
| **Konkluzione** | *Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë se institucioni përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve nëpërmjet raporteve periodike si dhe përdor metoda dhe instrumente të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.*<br><br>*Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.4**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. | Rezulton që, nëpërmjet analizës SWOT të Planit Strategjik të UART si dhe Raporti vjetor i punës artistike-mësimore-shkencore i stafit akademik të FAS, institucioni siguron përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.<br><br>*Evidenca 2.6 Mbi miratimin e planit të zhvillimit strategjik të UART për vitet akademike 2018-2025.*<br><br>*Evidenca 4.4 Raporti vjetor i punës artistike-mësimore-shkencore i stafit akademik të FAS për vitin akademik 2019-2020.* |
| **Kriteri 2.** Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të | Rezulton se institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët të cilët janë të angazhuar në GVB për Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të ketij program studimi, duke garantuar kështu ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. |

| | |
|---|---|
| cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. | *RVB Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Arteve Aktrim dhe Mësuesi.*<br>*Evidenca 1.17 Urdhëri i Rektorit të UART Prof. Kastriot Çaushi, me Nr. 283, datë 28.02.2022, "Mbi ngritjen e grupeve të punës për vlerësimin e brendshëm, në kuadër akreditimit të programeve cikli II.* |
| **Kriteri 3.** Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit. | Rezulton se anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit janë të përfshirë në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit në rang departamenti dhe fakulteti, siç pasqyrohet edhe në Rregulloren e Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Artit Skenik.<br>*Evidenca 2.3 VSA 35 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Artit Skenik.* |
| **Kriteri 4.** Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. | Bazuar në Rregulloren e Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni në UART, rezulton se institucioni rregullon integritetin akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit akademik, ndihmësakademik dhe studentëve.<br>*Evidenca 6.7 Rregullorja e Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, UART.* |
| **Kriteri 5.** Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje | Rezulton se, marrëveshjet e bashkëpunimit që institucioni ka me me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, me institucionet arsimore për realizimin e praktikave profesionale, si dhe marrëveshjet e bashkëpunimit në kuadër të projektit Erasmus dhe Erasmus + luajnë rol aktiv në sigurimin e brendshëm të cilësisë së këtij program studimi.<br>*Evidenca 3.3.1 Marrëveshje Bashkëpunimi për Zhvillimin e Praktikës Mësimore për Studentët e UART.*<br>*Evidenca 2.13 UART në Marrëveshjet e Bashkëpunimit në kuadër të projektit Erasmus dhe Erasmus +.* |

| | |
|---|---|
| me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. | *Evidenca 2.14 Marrëveshje Bashkëpunimi të UART me Institucione homologe brenda dhe jashtë vendit.* |
| **Konkluzione** | *Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë se institucioni siguron përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit duke përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët të cilët janë të angazhuar për Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të ketij program studimi, duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.*<br><br>*Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.5**<br><br>**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. | Rezulton se institucioni ka hartuar politika të qarta për publikimin e veprimtarive në kuadër të sistemit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, të cilat janë transparente dhe bërë publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare të UART.<br><br>http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=549&niveli=124 |
| **Kriteri 2.** Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe | Konfirmojmë që, institucioni ka hartuar Planin Strategjik Institucional, Rregulloren në rang njësie baze, Rregulloren per programin e studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.<br><br>*Evidenca 2.6 Mbi miratimin e planit të zhvillimit strategjik të UART për vitet akademike 2018-2025.* |

| | |
|---|---|
| legjislacionin për të dhënat personale. | *Evidenca 2.4.1 Rregullore e veprimtarisë së përgjithshme DAT*<br><br>*Evidenca 2.5.1 Rregullorja e programit të studimit MA Aktrim dhe Mësuesi.* |
| **Kriteri 3.** Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. | Konstatojmë se në Planin Strategjik të UART është hartuar analiza për sigurimin e cilësisë e shoqëruar me një plan masash që synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.<br><br>*Evidenca 2.6 Mbi miratimin e planit të zhvillimit strategjik të UART për vitet akademike 2018-2025.* |
| **Kriteri 4.** Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. | Konstatojmë se institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë, mbështetur në Rregulloren e e Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni dhe Rregulloren e veprimtarisë së përgjithshme DRRTV miratur nga Senati Akademik.<br><br>*Evidenca 6.7 Rregullorja e Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, UART.*<br><br>*Evidenca 2.4.1 Rregullore e veprimtarisë së përgjithshme DAT* |
| **Kriteri 5.** Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. | Nga shqyrtimi i RVB dhe diskutimet e realizuara nga takimi me Sektorin Mësimor & Kurrikulës, rezultoi se institucioni organizon takime periodike me stafin akademik, ndihmës dhe studentët për t'i informuar për arritjet dhe rekomandimet që duhet të plotesojë institucioni për rritjen e cilësisë së institucionit në tërësi dhe programeve të studimit, në veçanti.<br><br>*Evidenca 6.7 Rregullorja e Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, UART.* |
| **Konkluzione** | *Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë se institucioni ka hartuar Planin Strategjik Institucional, Rregulloren në rang njësie baze, Rregulloren për programin e studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara. Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk e përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Arteve "Aktrim dhe Mësuesi"**

a. **Pikat e forta dhe afirmime:**

1. FAS është i angazhuar në projekte ndërkombëtare që ndihmojnë në shkëmbimin e përvojave, mobilitetetеve për personelin akademik dhe studentët;
2. FAS ka hapësira të mjaftueshme dhe të pajisur me infrastrukture dixjitale, në funksion të programit të studimit;
3. FAS aplikon programe studimore të ndërtuara mbi Kornizën Evropiane të Kualifikimeve, me ngjashmëri me programe studimi evropiane;
4. FAS është pjesë e një projekti multinacional, ADNICH "Adriatic Network of artistic production for the development and enhancement of Intangible Cultural Heritage";
5. Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi në fusha të ndryshme, me interes të ndërsjelltë të palëve, me shumë institucione dhe institute të fushave të ngjashme me ato që FAS ofron;
6. Bashkëpunimi dhe pjesëmarrja në projekte të përbashkëta artistike, mes stafit akademik, Alumni dhe studentëve është një element shumë i rëndësishëm institucional;
7. Institucioni aplikon Masterclasses, si një formë e rëndësishme për përmirësimin e mësimdhënies, përmes njohjes së modeleve më të sukseshme të artistëve evropianë;

b. **Pika të dobta:**

1. Rezulton se numri i teksteve fizike dhe elektronike në fushën e edukimit (literature bazë dhe e këshillueshme) është i vogël për plotësimin e nevojave të studenteve në realizimin e leksioneve, detyrave dhe projekteve të kurseve me karakter psiko-pedagogjik që ky program studimi ofron për formimin e mësuesve të ardhshëm; ***(Standardi IV.3, Kriteri 4)***
2. Rezulton se, institucioni nuk ka paraqitur një raport analitik periodik mbi cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre; ***(Standardi V.4, Kriteri 5)***
3. Rezulton se institucioni nuk disponon instrumente matëse efikase për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive të punës artistike-mësimore dhe shkencore të stafit akademik; ***(Standardi V.5, Kriteri 4)***
4. Rezulton se, institucioni ka ngitur në strukturë të saj komisionin Ad-Hoc, Njësinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, por Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Bredshëm të Cilësisë është ende në proces realizimi. ***(Standardi VI.2, Kriteri 1)***

**Rekomandime**

1. Rekomandohet shtimi i fondit të teksteve fizike dhe elektronike në fushën e edukimit (literature bazë dhe e këshillueshme) për plotësimin e nevojave të studenteve në realizimin e leksioneve, detyrave dhe projekteve të kurseve me karakter psiko-pedagogjik që ky program studimi ofron për formimin e mësuesve të ardhshëm;
2. Rekomandohet që institucioni të hartojë raporte analitike periodike mbi cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre;
3. Rekomandohet ngritja e NJSBC dhe Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Bredshëm të Cilësisë referuar, Nenit 35 të Statutit UART;
4. Rekomandohet ngitja e instrumenteve matës për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive të punës artistike-mësimore dhe shkencore të stafit akademik si dhe hartimi i raporteve periodike për ecurine e tyre;

**Evaluation's conclusions for the second cycle study program Professional Master of Arts "Acting & Teaching"**

**a. Strengths and affirmations:**

1. FAS is engaged in international projects that help exchange experiences, mobility for academic staff and students;
2. FAS has sufficient space and is equipped with digital infrastructure, in accordance with the study program;
3. FAS applies study programs built on the European Qualifications Framework, as well as European study programs;
4. FAS is part of a multinational project, ADNICH "Adriatic Network of artistic production for the development and enhancement of Intangible Cultural Heritage.";
5. The institution has cooperation agreements in various fields, with mutual interest of the parties, with many institutions and institutes in fields similar to those that FAS offers;
6. Cooperation and participation in joint artistic projects between the academic staff, Alumni and students is a very important institutional element;
7. The institution applies Masterclasses, as an important form for the improvement of teaching, through the recognition of the most successful models of European artists;

**b. Weaknesses:**

1. Results that the number of physical and electronic texts in the field of education (basic and recommended literature) is small to meet the needs of students in the realization of lectures, assignments, and course projects with a psycho-pedagogical character that this study program offers for the training of future teachers; ***(Standardi IV.3, Criterion 4)***
2. Results that the institution has not submitted a periodic analytical report on the quality of incoming and outgoing students, as well as the quality of their employment; ***(Standard V.4, Criterion 5)***
3. The institution does not have efficient measuring instruments for reflecting the state, achievements and weaknesses of the artistic-teaching and scientific work of the academic staff; ***(Standardi V.5, Kriteri 4)***

4. The institution has set up the Ad-Hoc committee, the Internal Quality Assurance Unit, but The Permanent Commission of Quality Assurance is still in the process of being implemented; ***(Standardi VI.2, Kriteri 1)***

**Recommendation**

1. It is recommended to increase the fund of physical and electronic texts in the field of education (basic and recommended literature) to meet the needs of students in the realization of lectures, tasks and projects of courses with a psycho-pedagogical character that this study program offers for teacher training upcoming;
2. It is recommended to draw up periodic analytical reports on the quality of incoming and outgoing students as well as the quality of their employment;
3. It is recommended to set up the NJSBC and The Permanent Commission of Quality Assurance, referred to Article 35 of the UART Statute;
4. It is recommended to mount measuring instruments for reflecting the state, achievements and weaknesses of the artistic-teaching and scientific work of the academic staff, as well as the drafting of periodic reports on their progress;

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Nuk përmbushen | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË | | | | X |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | | X |